



БОРБА  
ПРОТИВ  
ТОРТУРА И  
НЕХУМАН  
ТРЕТМАН

RAPORT PËR  
**GJENDJEN DHE KUSHTET  
NË INSTITUCIONET  
NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE  
INSTITUCIONIN EDUKATIVO-KORREKTUES  
NË VITIN 2022**

SHKUP, TETOR 2022



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Evropian



M3MP

**Botues:**

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut  
i përfaqësuar nga Prof. Dr. Neda Zdraveva

**Autore:**

Ina Xhugumanova

**Redaktore:**

Dr. Elena Mujoska Trpevska

**Përkthimi nga maqedonisht në shqip:**

Shenasi Jaji

**Lektore:**

Elizabeta Poljoska

**Viti i botimit:**

2022

**Vendi i botimit:**

Shkup

**Numri i faqeve:**

68

**Dizajnimi grafik:**

Masiva Dooel Shkup

**Tirazhi:**

100 ekzemplarë



Ky projekt  
financohet nga  
Bashkimi Evropian



МЗМП

Përmajtja e këtij botimi është përgjegjësi vetëm e Komitetit i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe në asnjë mënyrë nuk i pasqyron qëndrimet e Bashkimit Evropian.

# PËRMBAJTJA

|   |    |
|---|----|
| <b>HYRJE</b> .....                                      | 6  |
| <b>SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE IDRIZOVË</b>       |    |
| <b>me pavijon të hapur në Veles</b> .....               | 9  |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME .....                          | 9  |
| KUSHTET MATERIALE .....                                 | 9  |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                | 13 |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....           | 14 |
| NDIHMA JURIDIKE.....                                    | 14 |
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                             | 14 |
| REKOMANDIME.....  | 15 |
| <b>PAVIJONI I HAPUR VELES PRANË SHNK IDRIZOVË</b> ..... | 17 |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                           | 17 |
| KUSHTET MATERIALE.....                                  | 17 |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                | 18 |
| ANGAZHIMI NË PUNË.....                                  | 18 |
| NDIHMA JURIDIKE .....                                   | 18 |
| REKOMANDIME.....  | 19 |
| <b>SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE SHTIP</b> .....    | 20 |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                           | 20 |
| KUSHTET MATERIALE.....                                  | 21 |
| ANGAZHIMI NË PUNË.....                                  | 23 |
| NDIHMA JURIDIKE .....                                   | 23 |
| REKOMANDIME.....  | 23 |
| <b>SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE PRILEP</b> .....   | 25 |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                           | 25 |
| KUSHTET MATERIALE.....                                  | 25 |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                | 26 |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....           | 27 |
| NDIHMA JURIDIKE .....                                   | 28 |
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                             | 28 |
| REKOMANDIME.....  | 28 |
| <b>SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE KUMANOVË</b>       |    |
| <b>me pavijon të hapur në Kriva Pallankë</b> .....      | 30 |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                           | 30 |
| KUSHTET MATERIALE.....                                  | 30 |
| ANGAZHIMI NË PUNË.....                                  | 31 |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                | 31 |
| NDIHMA JURIDIKE .....                                   | 32 |

|  |           |
|--|-----------|
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                                  | 32        |
| REKOMANDIME.....   | 33        |
| <b>PAVIJONI I HAPUR NË KRIVA PALLANKË PRANË</b>              |           |
| <b>SHNK KUMANOVË .....</b>                                   | <b>34</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                                | 34        |
| KUSHTET MATERIALE .....                                      | 34        |
| ANGAZHIMI NË PUNË.....                                       | 35        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                     | 35        |
| NDIHMA JURIDIKE .....  | 35        |
| REKOMANDIME.....   | 35        |
| <b>SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE E LLOJIT TË</b>         |           |
| <b>HAPUR - STRUGË.....</b>                                   | <b>37</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                                | 37        |
| KUSHTET MATERIALE .....                                      | 37        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                     | 38        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA .....               | 38        |
| NDIHMA JURIDIKE .....  | 39        |
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                                  | 39        |
| REKOMANDIME.....   | 39        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES MANASTIR.....</b>    | <b>40</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                                | 40        |
| KUSHTET MATERIALE .....                                      | 40        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                     | 41        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....                | 42        |
| NDIHMA JURIDIKE .....  | 43        |
| REKOMANDIME.....   | 43        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES OHËR .....</b>       | <b>45</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                                | 45        |
| KUSHTET MATERIALE .....                                      | 45        |
| ARSIMI .....   | 45        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                     | 46        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....                | 46        |
| REKOMANDIME.....   | 47        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES BURGU SHKUP.....</b> | <b>48</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                                | 48        |
| KUSHTET MATERIALE.....                                       | 48        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                     | 49        |
| NDIHMA JURIDIKE .....  | 50        |

|  |           |
|--|-----------|
| REKOMANDIME.....   | 50        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES STRUMICË.....</b>  | <b>52</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                              | 52        |
| KUSHTET MATERIALE.....                                     | 52        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                   | 52        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....              | 53        |
| NDIHMA JURIDIKE.....                                       | 53        |
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                                | 53        |
| REKOMANDIME.....   | 53        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES TETOVË.....</b>    | <b>54</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                              | 54        |
| KUSHTET MATERIALE.....                                     | 54        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                   | 55        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....              | 55        |
| NDIHMA JURIDIKE.....                                       | 56        |
| REKOMANDIME.....   | 56        |
| <b>INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES GJEVGJELI.....</b> | <b>57</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                              | 57        |
| KUSHTET MATERIALE.....                                     | 57        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                   | 57        |
| ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA.....              | 58        |
| NDIHMA JURIDIKE.....                                       | 58        |
| REKOMANDIME.....   | 58        |
| <b>SHTËPIA EDUKATIVE - KORREKTUESE TETOVË.....</b>         | <b>59</b> |
| TË DHËNA TË PËRGJITHSHME.....                              | 59        |
| KUSHTET MATERIALE.....                                     | 59        |
| ARSIMI.....  | 60        |
| QENDRAT PËR PUNË SOCIALE DHE GJYKATËSIT PËR FËMIJË.....    | 60        |
| KUJDESI SHËNDETËSOR.....                                   | 61        |
| PROCEDURAT DISIPLINORE.....                                | 63        |
| REKOMANDIME.....   | 63        |
| REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME.....                           | 65        |
| <b>Aneksi (Shtojca) I.....</b>                             | <b>66</b> |

## HYRJE

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Lufta kundër torturës dhe trajtimit çnjerëzor”, i mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian. Për qëllimet e projektit është nënshkruar Memorandum bashkëpunimi ndërmjet Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, Shoqatës Maqedonase të Juristëve të Rinj dhe Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve.

Në periudhën maj-gusht 2022 janë kryer vizita në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe atë edukativo-korrektues. Orari i vizitave me datën, orën dhe ekipin e saktë të vizitave është dhënë në Aneksin/Shtojcën e këtij raporti.

Gjetjet e përfshira në raport bazohen në vizitat e kryera nga grupi i monitorimit, i cili gjatë vizitave ka inspektuar të gjitha ambientet e burgjeve dhe institucioneve ndëshkimore-korrektuese, ka ofruar ndihmë juridike dhe këshillim psikiatrik falas për të dënuarit meshkuj dhe femra, ka zhvilluar biseda pothuajse me të gjithë drejtorët e këtyre institucioneve si dhe me punonjës të policisë së burgjeve, punonjës socialë, psikologë, avokatë etj.

Ajo që u vu re është se përkundër angazhimeve të shumta të shtetit, organizatave ndërkombëtare dhe vendase për të përmirësuar kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe atë edukativo-korrektues, megjithatë mangësitë sistemike ende ekzistojnë. Është e qartë se institucionet kompetente ende nuk kanë bashkëpunim adekuat ndërsektorial për problemet me të cilat ballafaqohen personat e privuar nga liria në këto institucione, dhe për rrjedhojë nuk arrijnë të përmbushin detyrimet e tyre ligjore për tejkalimin e problemeve që kanë vazhduar për një kohë të gjatë dhe pamundësojnë që personat e dënuar të gëzojnë të drejtat e tyre dhe të risocializohen në mënyrë përkatëse.

Qasja në kujdesin shëndetësor, arsimin, kushtet materiale adekuate të jetesës, programet e risocializimit dhe kushtet për zbatimin e tyre, asistencë post-penale janë shërbime ende të paimagjinueshme për personat që vuajnë dënimin me burg. Korrupsioni dhe ryshfeti janë pjesë e jetës së personave të dënuar të cilët na informojnë rregullisht për këtë, por nga frika se mos humbasin të drejtat dhe privilegjet e tyre në institucion, zyrtarisht nuk duan t'i

raportojnë këto raste. Veprimet e herëpashershme nga ana e autoriteteve shtetërore, të cilat zbulojnë sende të paligjshme për të cilat ekspertët dhe publiku i gjerë janë në dijeni në këto institucione, janë të pamjaftueshme. Thika, sende të mprehta, celularë, drogë dhe para do të ketë në institucionet ndëshkimore-korrektuese derisa personat kompetentë nuk do të marrin përgjegjësi për to. Ndryshe, jo vetëm korrupsioni, por edhe dhuna mes personave të dënuar dhe dhuna nga ana e personave të dënuar ndaj pjesëtarëve të policisë së burgjeve do të vazhdojë të jetë një praktikë e zakonshme.

Problemi me korrupsionin thellohet edhe më tej sepse shteti ende zbaton praktikën e emërimit të personelit joadekuat në poste drejtuese pa përvojë dhe njohuri për të menaxhuar institucionet ndëshkimore-korrektuese, të cilët me punën e tyre mund të shkaktojnë pasoja afatgjata, duke dëmtuar drejtpërdrejt personat e dënuar. Kështu, institucioni më i madh ndëshkimor-korrektues në Idrizovë drejtohej dhe drejtohet aktualisht nga persona të cilët nuk kanë asnjë përvojë të mëparshme në sistemin e burgjeve.

Përveç kësaj, ajo që është vërejtur dhe është veçanërisht shqetësuese është numri i vogël i ankesave të parashtruara nga personat e dënuar ndaj vendimeve të marra për shqiptimin e masave disiplinore. Është një praktikë e shpeshtë që të dënuarit nuk marrin dot vendimet për shqiptimin e masës disiplinore, për shembull nëse ndodhen në dhomë/qeli izolimi, vendimi ngjitet në derën e dhomës/qelisë së izolimit, kurse kontaktin me një organizatë joqeveritare, një jurist dhe/ose një avokat personat e dënuar mund ta realizojnë vetëm pasi të kenë mbaruar vuajtjen e masës disiplinore. Kështu, në periudhën nga janari deri në gusht të vitit 2022, në Drejtoinë për ekzekutimin e sanksioneve janë dorëzuar vetëm 15 ankesa nga ana e personave të dënuar, përkatësisht 6 në SHNK Shtip, 5 në INK Burgu Shkup, 2 në INK Nurgu Manastir dhe 2 në INK Burgu Kumanovë. Prej tyre, janë pranuar 5 ankesa, kurse 9 janë refuzuar. Arsyet më të zakonshme për parashtrimin e ankesave janë për gjetjen e celularit, përlëshje fizike, sulm fizik, kthimin me vonesë të të drejtave për të gëzuar privilegje dhe futjen në ambiente të alkoolit/drogës.

Në SHNK idrizovë, institucionin më të madh ndëshkimor-korrektues në vend, nuk është pranuar asnjë ankesë, një statistikë që na bën me dije se personat e

dënuar nuk kanë qasje adekuate në të drejtën e ankesës dhe nuk mësohen/udhëzohen se si ta përdorin të drejtën e ankesës.

Si praktikë pozitive, vërehet se më në fund ka filluar së funksionuari Qendra e trajnimeve në kuadër të SHNK Idrizovë dhe këtë vit ka trajnuar kuadro të rinj nga radhët e policisë së burgjeve të cilët para se të fillonin punën, kanë kaluar disa ditë trajnime në këtë Qendër. Ndonëse nuk mjafton që kuadrot e rinj të njihen me punën në sistemin e burgjeve, megjithatë është domethënëse dhe pozitive që më në fund ka nisur zbatimi dhe realizimi i këtyre trajnimeve.

Po ashtu, shteti ka vazhduar të investojë në përmirësimin e kushteve materiale në institucionet ndëshkimore-korrektuese, por disa nga këto institucione, si pavijoni i mbyllur në SHNK Idrizovë, INK Burgu Shkup dhe INK Burgu Ohër, nuk kanë asnjë mundësi për përmirësimin e kushteve të jetesës. Jo vetëm që nuk kanë kushte për përmirësim në infrastrukturë, por disa nga institucionet edhe një herë po ballafaqohen me problemin e mbipopullimit, siç janë institucionet SHNK Idrizovë, SHNK Prilep, INK Burgu Tetovë, SHNK Shtip, INK Burgu Stgrumicë, kurse disa rrezikohen të mbipopullohen siç është rasti me INK Burgu Manastir.

Mbipopullimi, veçanërisht në SHNK Idrizovë, ku ndodhen shumica e personave të dënuar të cilët janë në rrezik më të lartë të sigurisë, është një problem alarmant për të cilin shteti duhet urgjentisht të gjejë zgjidhje, si dhe për probleme të tjera sistematike që nëse nuk tejkalohen, risocializimi si një nga qëllimet kryesore të dënimit me burg, nuk mund të presim ulje të shkallës së krimit në vend.

Për këtë qëllim, organizatat e shoqërisë civile do të monitorojnë nga afër zbatimin e Strategjisë nacionale për zhvillimin e sistemit penitenciar në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2021-2025. Me implementimin e kësaj strategjie presim zbatimin korrekt të akteve ligjore dhe nënligjore, përmirësimin e kushteve dhe gjendjes nëpër burgje, por edhe forcimin e kapaciteteve dhe profesionalizmit të personelit të punësuar, si dhe forcimin e mbikëqyrjes së funksionimit të institucioneve ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese. Edhe pse duket e pamundur derisa të realizohet, pasi teksti i Strategjisë nis me fjalët e Nelson Mandelës, shpresojmë që në një të ardhme të afërt shteti të kapërcejë përfundimisht problemet sistematike në sistemin penitenciar.



# SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE IDRIZOVË

me pavijon të hapur në Veles

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Sipas të dhënave nga gushti i vitit 2020, SHNK Idrizovë ka një kapacitet të përgjithshëm prej 1253 shtretërish, ndërsa në momentin e vizitës numri i personave të dënuar me vuajtje të dënimit ishte 1115 persona. Prej tyre, 77 ishin gra të cilat janë duke e vuajtur dënimin e shqiptuar me burg në pavijonin e grave në SHNK Idrizovë.

## KUSHTET MATERIALE

### Pavijoni i mbyllur

Kushtet për vuajtjen e dënimit me burg në SHNK Idrizovë nuk i plotësojnë kushtet standarde minimale, një fakt që ngjallë pakënaqësi te të burgosurit. Ky konstatim plotësohet edhe nga të dhënat e organizatave të shoqërisë civile dhe Komitetit Evropian për Parandalimin e Torturës dhe Trajtimeve të Tjera Mizore dhe Çnjerëzore (CPT). Mirëpo, përkundër vërejtjeve të shumta dhe kritikave të vazhdueshme, në objektet “Ndërtesa” dhe “Ambulanca” që përbëjnë repartin e mbyllur të institucionit më të madh ndëshkimor-korrektues SHNK Idrizovë, nuk janë vërejtur asnjë ndryshim pozitiv në këto objekte.

Personat e dënuar vazhdojnë të vuajnë dënimin me burg në kushte substandarde, me nivel të lartë lagështie, e cila në disa pjesë të objektit arrinte deri në 66% të maksimumit të lejuar prej 50%. Në objektin “Ndërtesa”, disa nga dhomat akomodojnë 10-12 persona në dhoma që nuk plotësojnë standardet as për nga madhësia dhe as për nga kushtet materiale, lagështia dhe drita. Në muret e institucionit vërehen lehtësisht lloje të ndryshme insektesh, ndërsa të dënuarit kanë pickime të shumta në trup. Ata flenë në shtretër në 3 kate, ndaj ndodh shpesh që të dënuarit që flenë në katin e tretë të rrëzohen duke fjetur. Për krahasim, në disa dhoma të këtij objekti, personat e tjerë të dënuar vendosen në pozitë më të favorshme, kështu që në dhomë

me madhësi të njëjtë, 2 ose 3 persona vuajnë dënimin në kushte dukshëm më të mira për ta.

Një pjesë e personave të dënuar, më saktë gati 10 persona në objektin “Ndërtesa” në krahun e parë, të tretë dhe të katërt flinin në dysheme mbi dyshekë apo shtretër të improvizuar me batanije dhe jastëkë. Personat e dënuar që flenë në dysheme në korridore nuk kanë tualete, ndaj detyrohen të përdorin tualetet e personave të që kanë dhomë. Ky imazh i tillë konfirmon se mbipopullimi është ende një problem i pazgjidhur në këtë institucion, i cili përsëritet vit pas viti.

Krahas vërejtjeve të shumta lidhur me kushtet materiale, kritika të ashpra janë adresuar edhe për ushqimin i cili sipas deklaratave të personave të dënuar u jepet një herë në ditë në sasi të pamjaftueshme, kurse cilësia e tij është aq e keqe sa një pjesë e madhe nga personat e dënuar që kanë mundësi financiare hanë ushqim nga jashtë që u dërgohen në pako nga familjarët e tyre.

Në SHNK Idrizovë nuk ka dhomë ngrënie që mund të përdoret nga personat e dënuar, prandaj thika dhe mjete të tjera të ngrënies mund të vëreshin në të gjitha dhomat e institucionit. Një dukuri e tillë është e paligjshme dhe e rëndë, duke pasur parasysh se ky institucion, veçanërisht pavijoni i mbyllur, është vendi ku akomodohen personat e dënuar me rrezikshmërinë më të lartë për sigurinë e vendit. Prandaj, është e papranueshme që në këto dhoma të gjenden thika dhe mjete/vegla të tjera. Ato përdoren shpesh gjatë mosmarrëveshjeve verbale dhe fizike mes të dënuarve, kurse pjesëtarët e policisë së burgjeve gjatë kryerjes së detyrës shpeshherë lëndohen nga të dënuarit pikërisht me këto sende të mprehta.

Disa nga dhomat nuk kanë ngrohës uji, ndaj personat e dënuar në pjesën më kritike të institucionit me nivelin më të ulët të higjienës, në krahun e 4-t, ku akomodohen pjesa më e madhe e të dënuarve të etnisë rome, detyrohen të improvizojnë me kablllo për ngrohjen e ujit për larje, me çrast ka pasur edhe rast të goditjes nga rryma të një personi të dënuar i cili ka pësuar lëndime të rënda trupore gjatë dushit.

Në pavijonin e mbyllur në “Ndërtesë” ndodhen edhe dhomat e izolimit, të cilat janë gjetur në kushte substandarde, me lagështirë 60%, pa mundësi ajrimi të dhomës me ajër të pastër, pa dritë të mjaftueshme natyrore apo artificiale,

kurse tualetet në dhomën e izolimit u gjetën në nivelin më të ulët të higjienës. Për shkak të personave të dënuar për rastin “Divo Naselje” dhe mënyrës së veçantë të lëvizjes së tyre jashtë dhe ndalimit të kontaktit me persona të tjerë të dënuar, personat të cilët vendosen në dhomë izolimi kanë mundësi të ecin jashtë më pak se 1 orë gjatë ditë, gjë që u konfirmua edhe nga një pjesëtar i policisë së burgjeve. Personat e dënuar të cilët janë vendosur në dhomë izolimi na kanë raportuar se nuk janë kontrolluar rregullisht nga mjeku. Kundër vendimit për caktimin e masës disiplinore ata nuk kanë bërë ankesë për shkak se vendimi nuk iu është dorëzuar, por më pas është ngjitur në derën e dhomës nga ana e jashtme.

Pavijoni/Reparti i pritjes në institucion në momentin e vizitës kishte 17 persona. Në këto ambiente u vu re një lagështi prej 62.3%. Gjatë vizitës u konstatua se kabllot e rrymës në tualet janë ende të varura dhe paraqesin rrezik për shëndetin dhe jetën e personave të dënuar. Personat e dënuar të vendosur në repartin/pavijonin e pritjes mbahen në paraburgim për një kohë shumë të gjatë, nga 17 ditë deri në 4 muaj, për arsye sigurie.

Objekti i quajtur “Ambulanca” si dhe objekti “Ndërtesa” duhen të shemben tërësisht. Këtu nuk ka vend për rindërtim dhe përmirësim të kushteve ekzistuese. Lagështia është e pranishme në të gjitha ambientet, higjiena është në nivelin më të ulët dhe një numër i madh i personave të dënuar të akomoduar këtu vuajnë nga një lloj çrregullimi mendor.

Duke pasur parasysh kategorinë e personave që vuajnë dënimin në pavijonin e mbyllur, shteti duhet të bëjë përpjekje të veçanta për të krijuar një atmosferë të mirë të brendshme në këto pavijone. Kjo është në interes jo vetëm të trajtimit human të personave të dënuar në pavijon, por edhe në interes të ruajtjes efektive të kontrollit, sigurisë dhe sigurisë së personelit.

## **Pavijoni gjysmë i hapur dhe i hapur**

Kjo pjesë e institucionit është e re, e pandryshuar nga vizita e mëparshme, dhomat kanë kushte materiale dukshëm më të mira se sa dhomat në pavijonin e mbyllur. Ka rrjedhje të mjaftueshme të dritës natyrore, ajrosje, dritë artificiale, kurse higjiena është gjithashtu në një nivel shumë më të kënaqshëm.

Nga data 11 gusht 2022 janë hapur ambiente të reja në pavijonin e hapur të institucionit me kapacitet për 30 persona të dënuar.

Pavijoni/Reparti gjysëm i hapur akomodon 206 persona të dënuar, ndërsa pavijoni i hapur 133 persona të dënuar.

## Pavijoni i grave

Në këtë pjesë të institucionit janë kryer disa rikonstruksione që kanë përmirësuar kushtet materiale për gratë e dënuara si dysheme e re dhe dritare dhe dyer të reja plastike. Gratë e dënuara ankohen për praninë e çimjave dhe morrave në këtë institucion, komunikimin e dobët me edukatorët, higjenën e dobët në tualete, pamundësinë për të siguruar barnat e nevojshme, si dhe mungesën e shërbimeve gjinekologjike që Ministria e Shëndetësisë është e detyruar t'ua ofrojë.

Kabina e telefonit në pavijonin e grave është jofunksionale dhe sipas dëshmimeve të disa personave të dënuar, tableti përdoret kryesisht nga të njëjtët persona. Përveç ambienteve të hapura ku ka një stol me karrige, burgjet nuk kanë kushte për argëtim, sport dhe aktivitete profesionale.

Në pavijonin e grave nuk ka as një dhomë të përshtatshme në të cilën gratë e dënuara mund të kenë kontakt me fëmijët e tyre dhe cila dhomë duhet të ofrojë një atmosferë relaksuese dhe rekreative.

Survejimi video në pavijonin e grave është ende jofunksional.

## Vajzat që i vuanin masën edukative-korrektuese në SHNK Idrizovë

Ambientet që ishte paraparë për vajzat që vuanin masën edukative-korrektuese është vetëm një dhomë me shtretër, në të cilën vihej re prania e lagështisë. Vajzat kalonin dy orë gjatë ditës jashtë dhe sipas policisë së burgjeve shpeshherë kalonin jashtë së bashku me gratë e dënuara të rritura, të cilat kishin historik dhe sjellje më të mira. Vajzat që vuajnë masën edukative-korrektuese nuk përfshihen në procesin edukativo-arsimor, nuk kanë kushte për kalim cilësor të kohës së lirë, formim profesional, kurse edukatorët për gratë e dënuara të rritura janë të njëjtat që punojnë me vajzat e referuara në

vuajtjen e masës institucionale. Sipas deklaratave të vazhduara, ato shpeshherë kanë qenë dëshmitare të zënkave verbale mes grave të dënuara të rritura, pasi kanë qenë vetëm pak metra larg tyre.

Në kohën e publikimit të këtij raporti, asnjë vajzë nuk vuante masën edukative-korrektuese.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në këtë institucion ofrohet nga 1 mjek dhe 2 infermiere të cilët ndodhen në objekt vetëm për disa orë gjatë ditës, gjë që nuk mjafton për një objekt që numëron mbi 1000 persona të dënuar me probleme të ndryshme shëndetësore. Gjatë kohës së vizitës, punonjësit e policisë së burgjeve pranuan madje 3 kërkesa për kontroll mjekësor, të cilat nuk u kryen për shkak se mjeku ishte larguar nga objekti i burgut në orën 12.30.

Psikiatrit nga ekipi intervistuan gjithsej 53 persona të dënuar dhe 7 gra të dënuara. U morën informacione për prani të drogës në burg (marihuanë, heroinë dhe kokainë), buprenorfinë në treg ilegal, benzodiazepina, pengesa për përfshirjen në trajtimin me buprenorfinë dhe ndërprerjen e trajtimit me buprenorfinë pa pëlqim të personave, aksesin e vështirë te mjeku, psikiatër dhe barna të tjera në burg. Disa nga personat e burgosur kanë borxhe në lidhje me përdorimin dhe blerjen e drogave dhe substancave psikoaktive, gjë që rezultoi me dhunë, stres dhe trauma. Mungesa e personelit shëndetësor kontribuon në mungesën e kontrolleve të rregullta për depresionin, vetëvrasjen dhe përdorimin e substancave.

Është e nevojshme ofrimi i terapisë me buprenorfinë për të gjithë të dënuarit që kanë nevojë, për të vazhduar trajtimin e të dënuarve pa ndërprerje për asnjë arsye, përfshirë edhe zbatimin e parakohshëm të procedurës së tenderit nga Ministria e Shëndetësisë. Në këtë mënyrë do të parandalohet “tregu i zi” dhe do të ndikojë në reduktimin e dhunës, stresit dhe pasojave të tjera psikologjike e somatike.

Me rastin e planifikimit të trajtimit me OAT është e nevojshme përfshirja e personit të dënuar, kurse në vendimin se cili bar/ilaç duhet të aplikohet, më shumë vëmendje duhet t'i kushtohet përgjigjes ndaj trajtimit tek ai person sesa

nevojave të institucioneve në aspektin e kursimeve financiare, që në fund kushtojnë shumë më tepër.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Krahas angazhimit standard të personave të dënuar me punë në kujdestari, higjienë, lavanderi, kuzhinë etj., personat e dënuar në institucionin më të madh ndëshkimor-korrektues në vend nuk kanë kushte dhe programe për formim profesional dhe kalim cilësor të kohës së lirë.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Një avokat ka intervistuar gjithsej 38 persona të dënuar, 8 prej të cilëve janë të dënuara gra. Arsyet më të zakonshme për të cilat personat e dënuar në këtë institucion kanë kërkuar këshilla juridike kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor, kushtet materiale, ushqimin, të drejtën e lirit me kusht, transferimin në një institucion tjetër të vuajtjes së dënimit dhe ushtrimin e të drejtës së vizitës. Disa nga personat e dënuar u ankuan se ishin viktima të korrupsionit dhe se në institucion mund të merret me para gjithçka që dëshirohet, si: krevat, telefon, ujë të ngrohtë, terapi mjekësore, transferim në një institucion tjetër, shfrytëzim të privilegjeve etj. Një pjesë e madhe e personave të dënuar u ankuan për qëndrimin e mjekut psikiatër në institucion, si dhe për mungesën e personelit mjekësor, nuk arrijnë dot në radhë për t'u kontrolluar. Disa u shprehën se ndonjëherë kur parashirojnë kërkesë për pezullim të dënimit me burg për arsye shëndetësore, dokumentacioni mjekësor i tyre “ngec” diku me javë të tëra, pasi raportet nuk firmosen nga mjeku në institucion për shkak të vëllimit të tepërt të punës.

## **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Në periudhën janar-gusht 2022 janë ngritur gjithsej 324 procedime disiplinore ndaj personave të dënuar dhe konkretisht: 95 për posedim të celularit, 8 për posedim të metadonit dhe buprenorfinës, 79 për arratisje dhe largim nga institucioni, 5 për konsumim alkooli, 21 për sjellje të vrazhdë ndaj zyrtarëve, 30 për keqpërdorim të privilegjeve dhe 86 për konfrontim fizik.

Janë shqiptuar gjithsej 324 masa disiplinore dhe konkretisht: 2 vërejtje, 22 vërejtje publike, 196 masa izolimi nga 3 deri në 14 ditë, 91 masa disiplinore me kusht dhe 13 ndalime të përdorimit të privilegjeve nga 1 deri në 3 muaj.

SHNK Idrizovë nuk mban statistika për numrin e përgjithshëm të ankesave të dorëzuara në Drejtorinë për Ekzekutimin e Sanksioneve. Drejtoria ka paraqitur statistika se në periudhën nga janari deri në gusht të vitit 2022 nuk është parashtruar asnjë ankesë kundër vendimit për shqiptimin e masës disiplinore nga ndonjë person i dënuar në SHNK Idrizovë.

## REKOMANDIME:

1. Kushtet në objektet “Ndërtesa” dhe “Ambulanca” janë jashtëzakonisht çnjerëzore dhe degraduese për personat e dënuar. Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve duhet të gjejnë urgjentisht dhe menjëherë zgjidhje për të kapërcyer këtë situatë në të cilën ndodhen personat e dënuar që vuajnë dënimin me burg në pavijonin e mbyllur të institucionit;
2. Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Idrizovë të marrin masa për largimin e përhershëm të thikave dhe sendeve të tjera të mprehta nga ambientet e personave të dënuar;
3. Ministria e Shëndetësisë duhet të sigurojë qasje adekuate në kujdesin shëndetësor për personat e dënuar, përkatësisht:
  - Sigurimi i barnave dhe numri i mjaftueshëm i punonjësve shëndetësorë për të përmirësuar disponueshmërinë dhe aksesin e barnave, mjekut, psikiatrit, shërbimeve gjinekologjike dhe dentare;
  - Është e nevojshme të sigurohet terapi me buprenorfinë për të gjithë ata që kanë nevojë, e cila do të parandalojë “tregun e zi”, si dhe dhunën, stresin dhe pasojat të tjera psikologjike e somatike. Është e nevojshme të sigurohet trajtim i vazhdueshëm me buprenorfinë pa ndërprerje për çfarëdo arsye, duke përfshirë zbatimin e vonuar të një procedure tenderimi nga Ministria e Shëndetësisë;

- Gjatë planifikimit të trajtimit me OAT, është e nevojshme të përfshihet edhe personi i dënuar. Me rastin e marrjes së vendimit se cili ilaç do të aplikohet, është e nevojshme të merret parasysh më shumë për përgjigjen ndaj trajtimit tek ai person sesa për nevojat e institucioneve në aspektin e kursimeve financiare;
  - Psikoedukimi i njerëzve në terapi me OAT për efektet anësore të administrimit joadekuat të buprenorfinës, rreziqet e mbidozimit, rreziqet e sëmundjeve të transmetuara nga gjaku dhe dozimin jo optimal, si dhe motivimin e pacientëve për trajtim me një dozë dhe ilaç adekuat;
  - Ekzaminimi nga një mjek/psikiatër me rastin e pranimit në institucion si dhe monitorimi i mëtejshëm i vazhdueshëm i gjendjes shëndetësore për të kontrolluar mundësitë e paraqitjes së depresionit, vetëvrasjes, përdorimit të drogës dhe çrregullimeve të tjera mendore tek të gjithë personat e dënuar si dhe ata që i nënshtrohen masave disiplinore në dhomë izolimi;
  - Në të gjitha ndërhyrjet shëndetësore është e nevojshme që personat e dënuar të informohen në mënyrë të kuptueshme për ta, e cila do të parandalonte stresin, tensionin, depresionin dhe pasigurinë.
4. Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Idrizovë të ofrojnë kushte për aktivitete të lira, sportive, arsimore dhe profesionale për të gjithë personat e dënuar që të kalojnë kohën e lirë në mënyrë cilësore;
  5. Ministria e Drejtësisë, Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Idrizovë të ofrojnë kushte për aktivitete të lira, sportive, arsimore dhe profesionale për të gjithë personat e dënuar që të kalojnë kohën e lirë në mënyrë cilësore;
  6. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve duhet të vendosë survejim funksional me video në të gjithë institucionin, veçanërisht në pavijonin e grave, ku nuk ka fare.



# PAVIJONI I HAPUR VELES PRANË SHNK IDRIZOVË

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Pavijoni i hapur në Veles pranë SHNK Idrizovë numëron gjithsej 34 persona të dënuar, ndërsa kapaciteti i objektit është rreth 50 persona. Në institucion janë të punësuar 16 persona, nga të cilët 14 janë efektivë të policisë së burgjeve dhe 1 edukatore, e cila është njëkohësisht edhe udhëheqëse e sektorit për risocializim.

## KUSHTET MATERIALE

Në objekt, përveç personave të dënuar me trajtim të hapur, dënim me burg vuajnë edhe persona me trajtim gjysmë të hapur, që kanë dënim të shqiptuar me burg nën 3 vjet.

Objekti ka dy dhoma për 4 persona të dënuar dhe gjashtë dhoma për 8 persona të dënuar. Dhomat ishin relativisht të pastra, me dritë të mjaftueshme, dyshekë të pastër, çarçafë, tavolina ngrënieje. Në disa dhoma janë vërejtur edhe thika që mund të përdreshin për (vetë) dëmtim.

Në tualete u vu re një nivel i ulët i higjienës. Përveç kësaj, funksionojnë vetëm 2 dushe nga gjithsej 4, kurse në asnjë prej tualeteve nuk kishte të vendosur guackë tualeti, fakt që rëndon qasjen e personave më të moshuar, personave me probleme shëndetësore dhe personave me aftësi të kufizuara.

Në ambientet e bodrumit ishte vendosur një tavolinë pingpongu dhe një palestër, por për shkak të vendndodhjes së dhomës kishte një sasi të madhe lagështie, e cila i pengonte personat e dënuar të përdornin këtë dhomë. Gjatë vizitës, të gjithë personat e dënuar ishin të ulur në korridorin pranë dhomave dhe asnjë person nuk përdorte asnjë nga rekuizitat për aktivitete të lira.

Personat e dënuar përdorin telefonin zyrtar të institucionit për kontakte me botën e jashtme. Objekti ka edhe lavanteri me 2 makina për larjen e rrobave që shfrytëzohen nga personat e dënuar.

Shefi i institucionit na informoi se po përpiqeshin që një dhomë izolimi të funksiononte si qeli për vuajtjen e dënimit me burg.

Ushqimi në objekt shpërndahet sipas planit të miratuar më parë nga SHNK Idrizovë.

Në pavijonin e hapur nuk ka survejim funksional me video.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor në Veles ofrohet përmes Shërbimit Emergjent Mjekësor. Gjatë kohës së vizitës u konstatua se një pjesë e madhe e pakove me barna ishin me afat të skaduar të përdorimit, për këtë arsye u rekomandua që barnat të hiqen nga dollapi dhe të hidhen. Terapinë e bëjnë pjesëtarët e policisë së burgjeve, ndërsa disa nga të dënuarit kanë pasur terapi edhe në dhomat e tyre. Në objektin ku bëhen ekzaminimet e personave të dënuar ka një autoambulancë të improvizuar dhe nga punonjësit kemi marrë informacione se komunikimi në mes të dy institucioneve është i vështirë, kështu që shpeshherë ndodh që personeli shëndetësor nga Idrizova të mos ketë informacion se cilët persona të dënuar janë dërguar në vuajtje të dënimit në pavijonin e hapur në Veles.

## **ANGAZHIMI NË PUNË**

Jashtë institucionit janë të angazhuar me punë tre persona të dënuar, katër në kuzhinë, një shofer dhe disa persona të dënuar për mirëmbajtjen e higjienës në institucion.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Gjatë kohës së vizitës u zhvillua një bisedë me gjashtë persona të dënuar, të cilët kishin ankesa për ushtrimin e të drejtës për lirim me kusht dhe qasje në kujdes shëndetësor.

## REKOMANDIME:

1. Të përmirësohen kushtet materiale në tualete, me qëllim përdorimin e tyre të pandërprerë nga të gjithë personat e dënuar;
2. T'u kushtohet vëmendje datave të skadencës së barnave dhe të heqë ose asgjësojë me kohë ato që kanë skaduar;
3. Të përmirësohet komunikimi në mes të shërbimeve dhe sektorit shëndetësor në SHNK Idrizovë për ndarjen e informatave se cilët persona të dënuar janë dërguar në vuajtje të dënimit me burg në pavijonin e hapur në Veles, dhe
4. Të sigurohen kushte adekuate për aktivitete të lira, rekreative dhe profesionale në pavijonin e hapur në Veles.

# SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE SHTIP

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Vizita në burg nisi me një bashkëbisedim me drejtorin e institucionit, i cili ndau informacionin se në momentin e vizitës në burg vuanin dënimin 231 persona të dënuar, nga të cilët 15 ishin në arrati, 74 të dënuar të akomoduar në pavijonin e mbyllur dhe 142 në pavijonin gjysmë të hapur. SHNK Shtip ka një kapacitet prej 210 shtretër/vende.

Në institucion janë të punësuar 102 persona me uniformë. Si problem serioz spikat numri i vogël i të punësuarve në administratë, ku nga gjithsej 18 persona, vetëm dy janë përgjegjës për risocializimin e personave të dënuar. Drejtori dhe edukatorët e zgjidhin këtë problem të rëndë me takime të shpeshta me personat e dënuar, me biseda të drejtpërdrejta, por edhe duke caktuar një ditë në javë për biseda të drejtpërdrejta me drejtorin e institucionit, pas një kërkesë të paraqitur më parë për takim (zakonisht e shkruar në një fletë letre dhe të nënshkruar nga personi i dënuar). Një nga problemet kryesore me të cilat përballlet burgu është pikërisht risocializimi i personave të dënuar. Gjegjesisht, nga sektori i risocializimit, konkretisht numri i edukatorëve është reduktuar në dy persona që punojnë me të gjithë personat e dënuar. Në këtë institucion mbahet një libër i brendshëm i takimeve mes edukatorëve dhe personave të dënuar, ku regjistrohen të dhënat për të dënuarit, ankesa, koha dhe nënshkrimi i personit të dënuar për të regjistruar se është zhvilluar një bisedë. Në këtë mënyrë ata besojnë se administrata e burgut shmang problemet e mëparshme kur të burgosurit ankoheshin se nuk janë zhvilluar biseda, ndryshe nga pretendimet e punonjësve.

Higjiena dhe rendi në pjesën administrative dhe në ambulancë mbahen në nivel të duhur.

Mbipopullimi në SHNK Shtip vazhdon të jetë problem serioz, për shkak të rritjes së numrit të personave të dënuar që dërgohen për të vuajtur dënim me burg në këtë institucion, i cili nuk ka kapacitet të mjaftueshëm për të gjithë personat që dërgohen këtu.

Para vizitës nga Ministria e Punëve të Brendshme, në bashkëpunim me Drejtorinë për ekzekutimin e sanksioneve, në objekt është kryer kontroll për lëndë narkotike, gjatë të cilit nuk është gjetur drogë, por janë gjetur prova se aty janë përdorur lëndë narkotike. Për këto arsye, në pavijonin e pritjes kishte persona që e kishin tejkalar maksimumin e parashikuar ligjor për të qëndruar atje. Pas përfundimit të aksionit policor, drejtori ka bërë të ditur se personat do të vendosen në mënyrë adekuate nëpër qeli.

Gjatë vizitës u zhvillua një bisedë me mjekun e punësuar në institucion për trajtimin e personave të dënuar, veçanërisht trajtimin e personave të varur nga droga si dhe personave me probleme mendore. Në ambulancë janë vendosur shtretër dhe dyshekë të rinj në dhomat e spitalit. Ambulanca është e pajisur me një aparat të ri EKG, ortoskop, oftalmoskop, cilindër oksigjeni dhe instrumente të reja të nevojshme për kryerjen e detyrave.

## **KUSHTET MATERIALE**

I gjithë objekti i burgut është rinovuar me 36 radiatorë të rinj, si dhe është blerë një furrë e re për përgatitjen e bukës, të cilën personat e dënuar e përgatisin vetë.

Ambientet e ekzaminimit, që ndodhen në pjesën e ambulancës, është rinovuar me një dhomë gjumi të re, një dhomë të re dhe një tualet dhe banjo të rinovuar plotësisht.

Pavijoni i pritjes ishte duke u rinovuar gjatë kohës së vizitës. Në hyrje të godinës është vendosur një rampë e aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Në disa pjesë të burgut janë vendosur pllaka të reja.

Është instaluar një sistem i ri i energjisë diellore. Gjatë kontrollit të depove janë konstatuar pajisje të mira, ndërsa gjatë kontrollit të kuzhinës dhe magazinës është vërejtur progres në përgatitjen e ushqimit dhe menusë për personat e dënuar. Nga ana e personave të dënuar u konfirmua se ka progres në ushqimet që marrin, ndryshe nga vizita e mëparshme.

## Dhomat e izolimit

Në dhomat e izolimit hasëm njerëz që ishin vendosur aty edhe pse ishin të caktuar në krahët e tjera të burgut. Kjo situatë ndodh për shkak të mbipopullimit dhe mungesës së një vendi për akomodimin e duhur të tyre. Është befasues fakti që disa prej të dënuarve kërkojnë vullnetarisht të vendosen në këtë pjesë. Megjithatë, akomodimi në këto dhoma mbetet poshtërues dhe çnjerëzor, ato nuk ofrojnë asnjë privatësi as për përdorimin e tualetit dhe as nuk plotësojnë standardet minimale sa i përket madhësisë së dhomës, ndriçimit, ajrosjes etj.

## Pavijoni gjysmë i hapur

Mbipopullimi në institucion është përgjithësisht i dukshëm, por menaxhohet sipas mundësive. Të gjitha ambientet në pavijonin gjysmë të hapur kanë tavolina dhe karrige të unifikuara të vendosura nga institucioni. Dritaret janë nga plastika (PVC) dhe sapo të instaluara. Në të gjitha dhomat janë vendosur komodina të reja dhe drita led. Janë zëvendësuar dyert dhe janë ngjyrosur disa dhoma.

Biblioteka ka një përzgjedhje të madhe librash dhe e njëjta përdoret nga personat e dënuar.

## Pavijoni i mbyllur

Pavijoni i mbyllur ndodhet në një godinë të veçantë që është tërësisht e ndarë nga pjesa tjetër e SHNK-së. Personat kanë një vend të veçantë për shëtitje dhe nga institucioni jemi njoftuar se në oborr është duke u përgatitur një pjesë e cila do të jetë kopsht dhe do të përdoret për angazhimin në punë të personave të dënuar në pavijonin e mbyllur. Çdo kat ka nga tri dhoma qëndrimi ditor. Në krahët e burgut, dukshëm vërehet një ndryshim në kontekst pozitiv sa i përket mirëmbajtjes së higjienës, veçanërisht në tualete. Dezinsektimi dhe dezinfektimi bëhet rregullisht në të gjitha krahët, por disa persona të dënuar janë ankuar për shfaqjen e çimqeve, megjithëse është thënë se këto ambiente spërkaten rregullisht kundër insekteve. Natyrisht, është e nevojshme të ruhet higjiena e duhur nga vetë personat e dënuar. Në tualete janë vendosur pllaka

të reja, por në disa qeli disa prej pllakave janë thyer. Administrata e burgut i zëvendëson dhe i rehabiliton ato në përputhje me mundësitë.

Sa i përket pjesës së arsimit, nga burgu jemi informuar se shkollimin e kanë përfunduar 46 persona dhe pritet certifikimi i tyre, respektivisht dhënia e diplomave për arsimin e përfunduar.

## **ANGAZHIMI NË PUNË**

Në oborrin e institucionit po ndërtohet një amfiteatër i hapur dhe një kopsht nga ana e personave të dënuar. Një notë pozitive është se një pjesë e madhe e personave të dënuar janë të angazhuar në punë dhe rezultatet janë të dukshme sidomos në oborrin e burgut, ku përveç amfiteatrit po punohet në të gjitha fushat. Palestra është rinovuar me pllaka të reja, janë futur 5 pajisje të reja multifunksionale dhe një tavolinë e re ping pongu. Për personat e dënuar që punojnë në drugdhendje janë sjellë makina të reja gdhendjeje.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Gjatë kohës së realizimit të vizitës u zhvillua një bashkëbisedim me katër persona të dënuar, pyetjet dhe ankesat e të cilëve kishin të bënin me aksesin në kujdesin shëndetësor, kalimin në një trajtim më liberal, transferimin në një institucion tjetër ndëshkimor-korrektues dhe të drejtën e përdorimit të privilegjeve.

## **REKOMANDIME:**

1. Të merren masa për eliminimin e mbipopullimit në institucion nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve. Personat e dënuar nuk duhet t'i vuajnë dënimet me burg në dhomat e destinuara për vuajtjen e masës disiplinore - izolim, për arsye se nuk ka kapacitet të mjaftueshëm hapësinor;
2. Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për qasje adekuate në kujdesin shëndetësor të personave të dënuar, përkatësisht:
  - Është i nevojshëm skringu i drogës gjatë pranimit (pa vonesë) për zbulimin dhe ndërhyrjen e hershme të personave që përdorin drogë;

- Të bëhet vlerësimi/diagnoza në kohë (pa vonesë) në bazë të të dhënave anamnestike, analizave laboratorike, të dhënave të ndyrshme nga institucioni nga i cili është transferuar personi i dënuar etj.;
- Trajtimi i varësisë ndaj opiateve duhet të fillojë menjëherë pas pranimit pa vonesë me metadon ose buprenorfinë sa herë që ka nevojë për të;
- Gjatë transferimit të një personi me sindromën e varësisë ndaj opiateve, është e nevojshme të sigurohet trajtim i vazhdueshëm nëse trajtimi tashmë ka filluar dhe bashkëpunim ndërinstytucional, që nuk do të thotë se një person që nuk e ka filluar trajtimin më parë nuk mund të fillojë trajtimin nëse ka indikacione për atë;
- Të bëhet trajnimi i stafit - psikiatërve në Qendrën në Shtip për futjen në përdorim të trajtimit me buprenorfinë;
- Trajtimi i personave në institucionin ndëshkimor-korrektues është detyrim i shtetit dhe personat e dënuar nuk duhet t'i blejnë vetë barnat;
- Tramadol nuk është një ilaç mirëmbajtës për varësinë ndaj opiateve sipas mjekësisë së bazuar në dëshmi, kështu që duhet të përdoret buprenorfina ose metadoni;
- Dokumentimi i dhunës në burg si dhe i lëndimeve fizike është i domosdoshëm;
- Rritja e dozës me metadon është e nevojshme, e cila nuk duhet të arrihet nga ndërveprimi me barna të tjera, veçanërisht jo me benzodiazepinat, dhe
- Është e nevojshme të vendosen etiketa në paketimet për ruajtjen e metadonit (doza, data, koha për të cilën duhet të përdoret ilaçi, emri i barit në ambalazh, etj.).



# SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE PRILEP

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Shtëpia ndëshkimore-korrektuese Prilep ka kapacitet të përgjithshëm për 131 persona, ndërsa në momentin e vizitës numri i personave të dënuar me vuajtje të dënimit ishte 108 persona.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 68 persona, nga të cilët 46 janë policë të burgjeve, 6 janë të punësuar në sektorin e risocializimit, 3 instruktorë, një jurist, një kuzhinier, 2 veterinerë dhe pjesa tjetër janë të punësuar në administratë.

## KUSHTET MATERIALE

Në SHNK Prilep ka repart/pavijon pranimit/pritjeje, pavijon të hapur, gjysmë të hapur dhe të mbyllur, palestër, dhomë studimi, lavanteri, kuzhinë, dhomë ngrënie, dhomë për ekzaminim dhe vizita, ambulancë dhe një farmaci, një shëtitore dhe një fermë.

Ambientet për vuajtjen e masës disiplinore - izolim u gjetën në kushte substandarde, me dyshekë dhe jastëkë të vjetër dhe të ndotur, lavaman dhe tualet të ndotur dhe në njërin dhomë nuk kishte sistem funksional të thirrjes/alarmit.

Personat që janë në trajtim të mbyllur B3 dhe ata që ndodhen në pavijonin e pritjes, në raste të caktuara, për shkak të mungesës së kapaciteteve të mjaftueshme hapësinore, vendosen në një dhomë të përbashkët, e cila mund të ketë efekt të dëmshëm për personat e dënuar rishtazi të pranuar dhe risocializimin e tyre të mëtejshëm. Këto dhoma janë në gjendje relativisht të mirë, me shtretër dhe tualete të përshtatshme në dhoma. Në këtë seksion personat e dënuar kanë në dispozicion një shëtitore të zbrazët dhe një kabinë telefonike që mund ta përdorin për kontakte me botën e jashtme.

## Pavijoni i mbyllur

Në pavijonin e mbyllur të objektit ka dy dhoma me 8 dhe 9 krevate secila. Madhësia e dhomave, e cila nuk është më e madhe se 16 m<sup>2</sup>, nuk është adekuate për numrin e personave të dënuar që janë të vendosur në to. Në këto dhoma u vu re gjithashtu nivele të larta lagështie dhe mure të palyer. Ambientet e tualetit në këtë pjesë kanë një nivel të ulët të higjienës, me 1 dush dhe 2 tualete.

## Pavijoni i pritjes/pranimit

Pavijoni i pritjes në institucion ka dy dhoma, në njërin dhomë akomodohen 5 persona dhe në tjetrën 7 persona. Ambientet e tualetit u gjetën në kushte johigjienike, me pasqyrë të thyer dhe me 1 dush funksional dhe 2 tualete.

## Pavijoni i hapur dhe gjysmë i hapur

Pavijoni i hapur dhe gjysmë i hapur në objekt ka gjithsej 15 dhoma në gjendje relativisht të mirë, të pajisura me krevate, tavolina dhe karrige. Personat e dënuar kanë në dispozicion një dhomë të qëndrimit ditor si dhe një bibliotekë të pajisur plotësisht me libra në disa gjuhë. Biblioteka është rindërtuar dhe restauruar pasi ishte shkatërruar plotësisht nga zjarri. Tualeti në këtë pjesë të objektit është në gjendje dukshëm më të mirë se tualetet e tjera. Shëtitorja që përdorin të gjithë të dënuarit është e pajisur me një portë futbollit, një kosh basketbolli dhe një stol.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në këtë institucion ofrohet nga dy infermiere të cilat ndodhen aty çdo ditë nga ora 07:30 deri në orën 15:30, kurse sipas nevojës vijnë dhe në thirrje. Ndonëse infermierët qëndrojnë në objekt prej 3 vitesh për çdo ditë, ato nuk kanë të rregulluar një marrëdhënie të rregullt pune. Psikiatri në institucion vjen 2-3 herë në muaj, por edhe sipas nevojës. Personat e dënuar përdorin shërbimet stomatologjike jashtë institucionit. Terapia mjekësore sigurohet plotësisht nga institucioni nga fondet vetanake. Në momentin e vizitës, në terapi me metadon ishin 14 persona të dënuar dhe 3 persona të dënuar në terapi me buprenofinë.

Gjatë kohës së vizitës, psikiatri konstatoi se personat e dënuar me varësi nga droga po trajtohen me terapi joadekuate për varësinë ndaj opiateve, kështu që në vend të terapisë së duhur, personat e dënuar trajtohen me tramadol, leksilium, sanval etj. Një numër i madh i personave të dënuar detyrohen të blejnë buprenofinë në mënyrë të pavarur, më saktë 15 të dënuar marrin recetë nga mjeku psikiatër, prej të cilëve vetëm 3 persona e marrin atë pa pagesë përmes Ministrisë së Shëndetësisë. Personat e dënuar u japin para komandantëve për të marrë ilaçin nga farmacia dhe më pas ua dorëzojnë infermierëve që ua shpërndajnë terapinë çdo ditë pacientëve të mbikëqyrur (nën mbikëqyrje) në mëngjes dhe pasdite. Nëse një person merr buprenofinë në mbrëmje, doza e mbrëmjes administrohet në mënyrë të mbikëqyrur nga komandantët. Edhe pse një numër i madh i këtyre të dënuarve dhe familjeve të tyre janë në rrezik social dhe nuk kanë mjete për të marrë terapinë, ata janë të detyruar ta bëjnë këtë. Kështu, disa persona të dënuar në mungesë të fondeve të mjaftueshme marrin buprenofinë në një dozë më të ulët se sa është e nevojshme, të tjerët shesin rrobat e tyre për të marrë ilaçin, kurse disa anëtarë të familjeve të tyre shpenzojnë madje edhe ndihmën sociale për të furnizuar ilaçin.

Për shkak të kësaj situate, në këtë institucion ekziston një treg ilegal i buprenofinës ku një lingual prej 2 mg kushton rreth 200 denarë, kurse prej 8 mg rreth 400 denarë. Prezervativët nuk janë të disponueshëm në vendet e aksesueshme për të burgosurit, megjithëse policia e burgjeve pretendon se nuk ka asnjë problem për marrjen e prezervativit për këdo që e kërkon.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Sipas deklaratave të drejtorit, të angazhuar në punë janë rreth 33 persona të dënuar. Sfida më e madhe për drejtorin është procesi i risocializimit, sepse personat e dënuar nuk i kanë kushtet për të fituar ndonjë shkathtësi të punës në institucion, as nuk i kanë kushtet për aktivitete arsimore dhe të tjera profesionale. Përveç shëtitorës për të dënuarit në pavijonin e hapur dhe gjysmë të hapur, e cila është e pajisur me portë futbollit dhe kosh basketbolli, shëtitorja për personat e dënuar në pavijonin e mbyllur është e zbrazët.

## NDIHMA JURIDIKE

Gjithsej 12 persona të dënuar kanë kërkuar këshillime juridike lidhur me të drejtën e lirit me kusht, shfrytëzimin e privilegjeve dhe qasjen në kujdesin shëndetësor.

## PROCEDURAT DISIPLINORE

Nga janari deri në gusht të vitit 2022, në SHNK Prilep janë zhvilluar gjithsej 68 procedime disiplinore, kryesisht për kundërvajtje të kryera për posedim dhe përdorim të telefonit celular, ose më saktë 52 vepra të tilla për të cilat është shqiptuar masë disiplinore izolim pa të drejtë pune për 3-14 ditë. Kundër masës së shqiptuar disiplinore asnjë person i dënuar nuk ka parashtruar ankesë.

## REKOMANDIME:

1. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Prilep të bëjë përpjekje për përmirësimin e kushteve në dhomat e izolimit me qëllim të përmbushjes së standardeve të nevojshme;
2. SHNK Prilep duhet të bëjë përpjekje në të ardhmen që personat nga pavijoni i pranimit dhe ata që tashmë kanë marrë trajtim të mos akomodohen në dhoma të përbashkëta;
3. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Prilep të marrin masa për përmirësimin e kushteve në tualete në pavijonin e mbyllur dhe të pritjes/pranimit;
4. SHNK Prilep të mos akomodojë në një dhomë më shumë persona të dënuar sesa lejohet me ligj;
5. Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masa për përmirësimin e aksesit në kujdesin shëndetësor, përkatësisht:
  - Është e nevojshme që të gjithë personat për të cilët ka indikacion për mjekim me buprenorfinë të marrin buprenorfinë pa e paguar nga fondet e tyre por nga programi i varësisë së Ministrisë së Shëndetësisë;

- Kërkohet trajnimi i personelit shëndetësor për trajtimin farmakologjik të varësisë ndaj opiateve;
- Është e nevojshme të dokumentohen të gjitha ndryshimet në dokumentacionin mjekësor në mënyrë që të korrespondojnë me situatën aktuale;
- Nevojitet monitorimi i rregullt (skrining për përdorimin e substancave) dhe vlerësimi i gjendjes së personave të përfshirë në një program trajtimi me opioid nga profesionistët shëndetësorë, jo vetëm gjatë fillimit të terapisë, por rregullisht dhe në mënyrë konstante, veçanërisht kur merret një vendim për të ulur ose rritur terapinë;
- Është i domosdoshëm psikoedukimi për njerëzit me varësi në burg;
- Është e nevojshme të sigurohet një kasafortë për ruajtjen e metadonit në ambulancën e burgut;
- Është i nevojshëm edukimi për sëmundjet e varësisë, trajtimin dhe përfitimet e tij për personat me uniformë dhe personelin tjetër të burgjeve;
- Është e nevojshme të sigurohet aksesimi te prezervativët.

# SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE KUMANOVË

me pavijon të hapur në Kriva Pallankë

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Në kohën e realizimit të vizitës në SHNK Kumanovë ishin gjithsej 124 persona të dënuar dhe 30 persona në paraburgim.

Institucioni ndëshkimor-korrektues ka gjithsej 106 punonjës, nga të cilët 75 punonjës nga radhët e policisë së burgjeve, 68 burra dhe 7 gra, ndërsa 31 persona janë të punësuar në administratë.

## KUSHTET MATERIALE

Institucioni ka një pavijon gjysmë të hapur, të mbyllur, pritjeje dhe paraburgimi.

Dhomat dhe korridoret e institucionit ndëshkimor-korrektues kanë nivel të ulët të higjienës. U vu re se në disa ambiente niveli i lagështisë dhe i dritës ishte në kufirin e lejuar. Në shumicën e dhomave u gjetën dyshekë të ndotur, çarçafë dhe xhama të thyer të dritareve që ekipi kërkoi të hiqeshin. Disa nga dhomat nuk kishin dritë artificiale, respektivisht llambat ishin të thyera. Disa nga dhomat e izolimit ishin lyster rishtazi gjatë vizitës, kurse në disa prej tyre u vunë re tavolina të thyera, të cilat ekipi ka kërkuar që të ndërrohen në mënyrë që të mos shërbejnë për (vetë) dëmtim.

Institucioni ende përballlet me problemin e furnizimit me ujë dhe gjatë vizitës drejtori bëri me dije se pret ardhjen e përfaqësuesve nga një kompani që duhet të inspektojë terrenin për t'i gjetur zgjidhje këtij problemi, i cili daton që nga hapja e këtij institucioni.

Gjatë kohës së vizitës disa nga dhomat ishin duke u lyster, si dhe u vu re banjo e re për personat e dënuar si dhe lavamani në pavijonin e mbyllur të objektit, i cili u mundëson të dënuarve akses më të lehtë në ujin, të cilin nuk e kanë nëpër

dhoma. Në tualete dushet ishin funksionale, ndryshe nga më parë kur funksiononin mezi 1 apo 2 dushe.

Burgu ka edhe ambiente që shërbejnë si: kuzhinë, dhomë ngrënie, punishte, klasë, dhomë për ceremonitë fetare, bibliotekë, palestër dhe dy dhoma për vizitë të të dënuarve dhe të paraburgosurve dhe lavaxantë. Gjatë vizitës në kuzhinë nuk kishte asnjë orar për shpërndarjen e ushqimit për javën aktuale, por ekipi u informua se orari tashmë ishte përgatitur dhe miratuar nga drejtori.

Shëtitoret për personat e pavijonit gjysmë të hapur është një hapësirë e gjerë që ka një fushë basketbolli.

## **ANGAZHIMI NË PUNË**

Në institucion personat e dënuar që janë të angazhuar merren me kujdestari në burg. Gjatë vizitës nuk u gjet asnjë person i vetëm i angazhuar në punë. Institucioni ka të punësuar 1 referent për edukimin e personave të dënuar në fushën e bujqësisë dhe blegtorisë dhe 1 për edukimin e personave të dënuar për bravandreqës - punë të zejtarisë.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor në SHNK Kumanovë kryhet nga tekniku mjekësor i punësuar në institucion. Mjeku vjen në institucion dy herë në javë, dhe për shkak të largësisë së madhe të institucionit nga qytetet e Kumanovës dhe Sveti Nikollës, ndihma emergjente mjekësore nuk mund të arrijë me kohë për t'iu ofruar kujdes shëndetësor personave të dënuar.

Psikiatrit nga ekipi intervistuan gjithsej 11 persona. Nga biseda e mjekëve psikiatër me personat e dënuar, u konstatua se në mesin e të dënuarve ka persona me çrregullime nga përdorimi i substancave psikoaktive, të cilët trajtohen me “terapi të thatë”, siç e quajnë punonjësit e institucionit, që gjithsesi nuk përfaqëson trajtim sipas mjekësisë së bazuar në prova, që rezulton me dhunë, përleshje, gjendje depresive, ankth, autoagresion, tentativa për vetëvrasje, agresion dhe krijim të tregut të zi të barnave për trajtimin e varësisë sipas mjekësisë së bazuar në dëshmi. Në burg është e pranishme edhe droga - marihuana dhe tableta me buprenorfinë të marra në

mënyrë të paligjshme, sipas deklaratave të punonjësve dhe personave të dënuar.

Të gjithë personat e dënuar që u intervistuan kanë një çrregullim të shkaktuar nga përdorimi i substancave, të cilët vuajnë nga gjendje shoqëruese si ankthi, depresioni, autogresioni, agresiviteti etj. Edhe pse disa prej tyre janë persona me varësi ndaj opiateve, nuk ka mundësi trajtimi me terapi agoniste opioidale (OAT) në burg dhe vetëm një pjesë e vogël e personave në burg që janë të varur nga opiatet blejnë terapi OAT sipas mjekësisë së bazuar në dëshmi. Trajtimi joadekuat mbart rrezikun e varësisë jatrogjenike ndaj anksiolitikëve dhe të gjithë personat e dënuar janë gjetur se kanë zhvilluar varësi ndaj anksiolitikëve, e cila është e vështirë për t'u trajtuar, ndryshe nga varësia ndaj opioideve, e cila, nëse trajtohet në mënyrë adekuate, redukton çrregullimet komorbide, agresionin dhe tregun e zi.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Është zhvilluar një bisedë me gjithsej 10 persona të dënuar të cilët kanë pasur nevojë për këshillime juridike. Problemet më të shpeshta me të cilat përballen kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor, ushqimin në objekt, shfrytëzimin e privilegjeve, transferimin në një institucion tjetër ndëshkimor-korrektues etj.

## **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Nga janari deri në gusht të vitit 2022 janë zhvilluar gjithsej 29 procedime disiplinore, 26 për kundërvajtje më të rëndë disiplinore dhe 3 për kundërvajtje më të lehtë disiplinore. Ndër shkeljet më të rënda disiplinore, më të zakonshmet janë shpërdorimi i privilegjeve, përkatësisht 11 shkelje dhe 7 për arratisje ose tentativë për t'u arratisur nga vuajtja e dënimit me burg. E drejta e ankimit është shfrytëzuar nga 3 persona për kundërvajtje më të rëndë disiplinore, ndërsa në procesverbalet e Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve thuhet se 2 persona kanë shfrytëzuar të drejtën e ankimit nga ky institucion.



## REKOMANDIME:

1. Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve së bashku me SHNK Kumanovë të gjejnë zgjidhje për problemin e furnizimit me ujë;
2. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve duhet të bëjë përpjekje për rinovimin e shëtitores për personat e dënuar në pavijonin e mbyllur për të ofruar më shumë kushte për kohë të lirë cilësore;
3. SHNK Kumanovë të bëjë përpjekje për përmirësimin e higjienës në institucion dhe
4. Ministria e Shëndetësisë të sigurojë:
  - Terapi me agonist opioid, si dhe të zhvillojë trajnime për punonjësit duke përfshirë edhe psikiatrit që punojnë me personat e dënuar të varur nga opiatet;
  - Personat e dënuar me varësi ndaj opiateve nuk duhet të referohen në institucione ku terapia me agonist opioid nuk është e disponueshme, pavarësisht nëse personi aktualisht është duke marrë terapinë apo jo, dhe për shkak se është një sëmundje kronike dhe përsëritëse;
  - Testimin e personave të dënuar që janë të varur për HIV, hepatit C dhe B si dhe trajtimin e hepatitit C, i cili nëse nuk trajtohet mund të rrezikojë seriozisht shëndetin e personave të dënuar.

# PAVIJONI I HAPUR NË KRIVA PALLANKË PRANË SHNK KUMANOVË

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Pavijoni i hapur i Kriva Pallankës pranë SHNK Kumanovë numëron gjithsej 20 persona të dënuar, ndërsa kapaciteti i institucionit është 23 persona. Janë gjithsej 12 punonjës, nga të cilët 7 punonjës në radhët e policisë së burgjeve, 2 instalues, një kuzhinier, një arkëtar dhe një udhëheqës.

## KUSHTET MATERIALE

Gjatë kohës së vizitës u konstatua se dhomat në objekt janë rindërtuar. Objekti ka gjithsej 5 dhoma, njëra prej të cilave ka shërbyer si dhomë izolimi, kurse tani është përshtatur për vuajtjen e dënimit me burg. Në dhomë është vërejtur një nivel më i lartë lagështie, më saktë është vërejtur lagështi prej 53%. Dyshemeja në pjesën tjetër të dhomave është mesatare, personat e dënuar kanë dyshekë dhe krevat të pastër dhe dritë të mjaftueshme të ditës dhe dritë artificiale në dhoma. Dy nga dhomat që dikur kanë shërbyer si dhomë izolimi, për shkak të mosfunksionalitetit të tyre, aktualisht shërbejnë si magazina.

Tualeti në objekt ka ende një nivel shumë të ulët të higjienës me kanalizime të vjetra dhe të rrënuara.

Udhëheqësi ka bërë të ditur se më në fund kanë në dispozicion një veturë zyrtare, të cilën më së shpeshti e përdorin për transportin e personave të dënuar në Shtëpinë e Shëndetit.

Dhoma e ngrënies dhe kuzhina u gjetën në gjendje të rregullt, me një orar të shfaqur të ushqimit. Kutia për parashtrimin e ankesave pranë Avokatit të Popullit ishte e mbyllur, ndryshe nga vizita e mëparshme e kryer në vitin 2020.

Sfida më e madhe mbetet ngrohja në godinë, problemi i të cilit ende nuk është zgjidhur. Me një rast, disa vite më parë, udhëheqësi i objektit ka parandaluar mbytjen e personave të dënuar nga monoksid karboni.

Ura në hyrje të objektit më në fund është rikonstruktuar, gjë që ka përmirësuar sigurinë e të gjithë njerëzve që vizitojnë pavijonin e hapur.

## **ANGAZHIMI NË PUNË**

6 persona të dënuar janë të angazhuar në punë jashtë institucionit, në marrëveshje me komunën për punë pranë shtratit të lumit.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor në Kriva Pallankë ofrohet përmes Shërbimit Emergjent Mjekësor. Drejtuesi i institucionit theksoi se nuk ka persona të dënuar që po trajtohen nga varësia ndaj opiateve.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Është zhvilluar një bisedë me një person të dënuar, për të cilin ka qenë evidente nevoja për të biseduar me një psikiatër. Gjegjësisht, në një bisedë me punonjësit jemi njoftuar se personi i dënuar ka pasur një debat verbal dhe fizik me një person tjetër të dënuar, për arsye banale. Në të kaluarën, personi i dënuar ishte trajtuar për varësi nga opiatet, ishte shtruar disa herë në një institucion psikiatrik dhe "me vetë dëshirë" e kishte ndërprerë terapinë. Ai është duke vuajtur dënimin me burg për shkak të një veprë të dhunshme penale, për këtë arsye ishte evident edhe shqetësimi ynë për dhunë të mundshme ndaj të dënuarve të tjerë për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe u kërkua që personi të ekzaminohet nga psikiatri sa më parë.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Kumanovë të sigurojnë kushte adekuate në tualet;
- 2.** Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe SHNK Kumanovë të bëjë përpjekje që të dënuarit të kenë më shumë kushte për aktivitete të lira, sportive, profesionale dhe arsimore;
- 3.** Ministria e Shëndetësisë duhet të ofrojë shërbime psikiatrike për personat e dënuar dhe punonjësit t'u kushtojnë më shumë vëmendje

personave të dënuar të cilët kanë nevojë të dukshme për një ndihmë të tillë;

4. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve të gjejë zgjidhje për problemin e ngrohjes.

# **SHTËPIA NDËSHKIMORE - KORREKTUESE E LLOJIT TË HAPUR - STRUGË**

## **TË DHËNA TË PËRGJITHSHME**

SHNK Strugë ka një kapacitet për gjithsej 60 persona, ndërsa në momentin e vizitës 51 persona ishin duke vuajtur dënimin me burg.

Përveç drejtorit dhe zëvendës drejtorit, në institucion janë të punësuar gjithsej 20 persona, nga të cilët 12 policë të burgjeve, 3 punonjës në sektorin e risocializimit, një instruktor kuzhine, një arkivist, një sekretar teknik, një person në shërbimin amë dhe një jurist.

## **KUSHTET MATERIALE**

SHNK Strugë ka bërë rikonstruksione në aspektin e kushteve materiale. Janë instaluar dritare të reja, sepse të vjetrat ishin të vjetruara, është ndërruar çatia, janë ndërruar dyert e dhomave të personave të dënuar.

Në katin përdhësë të objektit ndodhen gjithsej 3 dhoma, dy me 2 krevate dhe një me 3 krevate. Drita e ditës në këtë dhomë ishte e mirë, me një nivel lagështie në korniza që tejkalonte pak kufirin e lejuar, ose më saktë 51%.

Grupi i monitorimit nuk është lejuar të shohë një nga dhomat e të dënuarve që kishin dalë për të punuar në një kompani. Ndonëse zëvendësdrejtori ishte informuar se ekipi ka leje për hyrje të papenguar në të gjitha dhomat nga ana e Administratës, zëvendësdrejtori informoi se të dënuarit lejohen të marrin me vete çelësin e dhomës, ndërsa punonjësit e institucionit nuk kanë çelës rezervë.

Në katin e parë të objektit ka gjithsej 16 dhoma të pajisura me 2 ose 3 krevate, televizor, tavolina, karrige. Disa nga dhomat kishin frigoriferë dhe ushqime. Gjysma e dyshekëve janë të rinj dhe janë siguruar nga donacionet. Në përgjithësi higjiena nëpër dhoma është në nivel të kënaqshëm, ndërsa mobiljet janë relativisht të vjetra, por me dyshekë dhe çarçafë të pastër. Disa nga dhomat ngrohen me panele gjatë kohës së dimrit.

Dy tualetet dhe banjo në objekt janë përgjithësisht të papastra, me pajisje të vjetruara.

Në dhomën që përdoret për izolim për vuajtjen e masës disiplinore izolim, në kohën e vizitës ishte hequr qilimi me arsyetimin se do të zëvendësohej dysHEMEJA. Dhoma ishte e ndotur dhe kishte aromë lagështie.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor ofrohet nga Shtëpia e Shëndetit, gjegjësisht nëpërmjet mjekut dhe infermieres që vijnë në objekt 3 herë në javë. Terapia mjekësore, ndryshe nga shumica e institucioneve ndëshkimore-korrektuese që e sigurojnë vetë, këtu ofrohet përmes shtëpisë së shëndetit. Në momentin e vizitës, 5 persona ishin në terapi me metadon dhe 2 me buprenofinë.

Ambulanca e institucionit ka një shtrat ekzaminimi dhe një kabinet ilaçesh. Gjatë kontrollit të barnave, ekipi konstatoi se ka disa ilaçe që kishin afat të skaduar përdorimi. Në ambulancë kishte edhe një kuti metalike me terapi metadoni e cila ishte e hapur. Në shishe kishte data të shkruara që tashmë kishin skaduar, ndërsa terapia gjendej ende në ambalazh. Pas kontrollit të bërë së bashku me infermierën, ekipi u informua se bëhej fjalë për një gabim në datat. Në një bisedë me personat e dënuar që marrin terapi me metadon, jemi informuar se terapia është e përshkruar rregullisht dhe nuk kanë pasur asnjë ndërprerje. Në ambulancë kishte edhe një thikë të madhe kuzhine, e cila u vu re se ishte hequr për shkak të rrezikut nga lëndimi.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Nëpër kompani janë të angazhuar në punë rreth 15 persona dhe pothuajse të gjithë janë të punësuar brenda institucionit, me përjashtim të personave me sëmundje kronike.

Përsa i përket aktiviteteve të kohës së lirë dhe vokacionit, institucioni ka një oborr me stola, një palestër me pajisje të improvizuara dhe një tavolinë pingpongu. Punonjësit e sektorit të risocializimit na njoftuan se me personat e dënuar kanë biseda në grup në dhomën e ngrënies, e ndonjëherë edhe aktivitete individuale.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Gjithsej katër persona të dënuar kanë kërkuar këshillime juridike në lidhje me lirimin me kusht dhe nxjerrjen e dokumenteve personale.

## **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Nga janari deri në gusht të vitit 2022 janë iniciuar gjithsej 3 procedura disiplinore dhe asnjë person nuk ka ankimuar vendimin për shqiptimin e masës disiplinore.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** INK Strugë nuk guxon të kufizojë hyrjen në ambiente për përfaqësuesit e sektorit civil të cilët kanë leje nga Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve për të hyrë në të gjitha hapësirat në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe për të biseduar me personat e dënuar;
- 2.** INK Strugë nuk duhet të lejojë personat e dënuar që punojnë jashtë institucionit të kenë dhe mbajnë çelësin e dhomës dhe institucioni të mos ketë çelës rezervë;
- 3.** Ministria e Shëndetësisë duhet të shënojë datën e saktë në shishet e metadonit kur personat e dënuar duhet ta përdorin atë, dhe
- 4.** Ministria e Shëndetësisë duhet t'i kushtojë vëmendje datës së skadencës së pilulave që ndodhen në ambulancë.

# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES MANASTIR

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Manastirit ka një kapacitet të përgjithshëm për 88 persona, ndërsa në momentin e vizitës dënimin me burg e vuanin gjithsej 83 persona të dënuar.

Institucioni ka të punësuar 22 pjesëtarë të policisë së burgjeve, një avokate që punon edhe si edukatore, një avokat për pranimin dhe lirimin e të dënuarve, një psikolog dhe një pedagog - sektori për risocializim. Institucioni ka të punësuar edhe 2 instruktorë, një për bujqësi dhe një për blegtori. Gjatë periudhës së ardhshme pritet që 5 punonjësve në administratë dhe 2 punonjësve të policisë së burgjeve t'u ndërpritet marrëdhënia e punës për shkak të plotësimit të kushteve për pension pleqërie.

## KUSHTET MATERIALE

Burgu i Manastirit është një objekt krejtësisht i ri, i cili ka mbajtur të njëjtën pamje që nga hapja e deri më sot.

Institucioni është i ndarë në pavijon të hapur/gjysmë të hapur dhe të mbyllur. Për shkak të numrit të madh të personave të dënuar dhe kapaciteteve të pamjaftueshme hapësinore, personat e dënuar grupohen në të njëjtat dhoma, megjithëse me tretmane të ndryshme. Kështu, ka raste kur një person me tretman të mbyllur B3 vuan dënimin me burg në pavijon të hapur/gjysmë të hapur, ndërsa dikush me tretman më liberal mund të akomodohet edhe në pavijonin e mbyllur të institucionit.

Në momentin e vizitës, reparti/pavijoni i pritjes së institucionit funksiononte si pavijon i mbyllur, për shkak të kapacitetit të pamjaftueshëm hapësinor.

Dhomat janë përgjithësisht me nivel të kënaqshëm të higjienës, me çarçafë dhe dyshekë të pastër, dritë të mjaftueshme të ditës dhe dritë artificiale, kurse lagështia nuk vërehet në asnjë dhomë. Tualetet ndodhen nëpër dhoma dhe ishin në gjendje të mirë.



Për kutitë postare të ambulancës dhe drejtorit, të cilat ishin vendosur në një nga korridoret e institucionit, një i dënuar na njoftoi se nuk janë në funksion, gjegjësisht askush nuk i zhbllokon kutitë postare dhe nuk i shqyrton letrat që i lënë personat e dënuar.

Personat e dënuar në përgjithësi nuk kanë pasur ankesa për kushtet materiale dhe ushqimin në institucion, por kanë vërejtur se në institucion nuk ka ujë të nxehtë për larje, përveç gjatë orëve të mëngjesit dhe për një kohë të shkurtër gjatë ditës.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor në burg ofrohet nga një mjeke dhe një infermiere të cilat qëndrojnë në institucion çdo ditë, nga ora 7:30 deri në 15:30, dhe në thirrje nëse është e nevojshme. Psikiatri në institucion vjen 2-3 herë në muaj dhe sipas nevojës. Shërbimet stomatologjike personat e dënuar i përdorin jashtë institucionit. Terapia mjekësore sigurohet plotësisht nga institucioni nga fondet e tij vetanake.

Me terapi agoniste opioidale po trajtohen 26 persona, nga të cilët 16 me buprenorfinë dhe 10 me metadon. Në ambulancë kanë qenë të pranishëm një mjeke e mjekësisë së përgjithshme dhe një infermiere, ndërsa më vonë ka ardhur edhe një psikiatër për të pranuar në burg një person të ri i cili ka sindromën e varësisë ndaj opiateve, i cili është transferuar nga burgu i Prilepit. Të gjithë të pranurit ekzaminohen në 24 orët e para sipas deklaratave të mjekes dhe nëse është e nevojshme thirret një psikiatër që vjen rregullisht në burg çdo 2 javë. Në ambulancë nuk ka teste depistimi për drogë dhe substanca psikoaktive, kështu që ato nuk përdoren as gjatë pranimit, as për monitorim dhe korrigjim të terapisë. Në ambientet e burgut jo, por në ambientet e paraburgimit ka tentativa dhe janë bërë vetëvrasje. Së fundmi, institucioni ka marrë një mjet për kontrollin e vetëvrasjeve dhe ata planifikojnë të fillojnë ta përdorin atë. Aktualisht bëjnë depistimin e tuberkulozit sepse në burg ka persona me tuberkuloz dhe një herë në vit përmes ISHP dhe Shoqatës Hera bëhet testimi për HIV, hepatit B dhe C (hera e fundit më 26.07.2022). Terapia me opioidet zvogëlohet nga mjekja e përgjithshme me kërkesë të personave që trajtohen, por ajo nuk fillon përdorimin e opioideve dhe as nuk e rrit terapisë. Mjekja njofton se e ka njoftuar me shkrim drejtorin për

keqpërdorimin e tabletave të buprenorfinës (disa nga personat i nxjerrin tabletat nga goja para komandantëve dhe ata nuk reagojnë). Po ashtu, thuhet se bashkëpunimi me Qendrën Shëndetësore është shumë i dobët, askush nuk dëshiron të punojë në burg dhe se puna është jashtëzakonisht e vështirë dhe nuk e vlerësojnë punën në lidhje me rrezikun dhe as nuk kanë përfitime. Psikiatri njofton se nga burgu i Prilepit vijnë persona të cilët marrin buprenofinë dhe trodon në të njëjtën kohë dhe një ose dy preparate benzodiazepine (gjendje e konstatuar në burgun në Prilep), e lidhur me atë që disa persona që vijnë nga ai burg konsiderojnë se ajo nuk është e mirë si mjeku nga Prilepi që u jep gjithçka që u nevojitet. Punonjësit e shëndetësisë raportojnë gjithashtu se kanë presione indirekte nga Ministria e Shëndetësisë për të mos përdorur aq shumë buprenorfinë, presion që komunikohet gjithmonë verbalisht.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Drejtori i institucionit bëri me dije se rreth 50% e personave të dënuar janë të angazhuar në punë, respektivisht 22 persona në ndërtesën e institucionit, 14 persona në ekonomi, 4 persona në ndërmarrje dhe 2 persona në bahçe. Edhe pse një numër i madh i personave të dënuar janë të angazhuar në punë, një angazhim i tillë nuk kontribuon që personat e dënuar të fitojnë aftësi të caktuara që do t'u ndihmonin pas largimit nga institucioni për angazhimin e tyre të punës jashtë komunitetit. Edhe pse institucioni ka kushte për zdrukthtari, ai nuk është vënë në funksion për shkak të kostos së lartë të energjisë elektrike.

Për sa i përket aktiviteteve të lira, objekti ka një bibliotekë dhe një palestër që personat e dënuar mund ta përdorin për të kaluar kohën e lirë.

Shëtitorja e pavijonit të hapur dhe gjysmë të hapur është e hapur nga mëngjesi deri në orët e pasdites. Personat e dënuar kanë në dispozicion një portë futbollit dhe një kosh basketbolli, ndërsa personat e dënuar nga pavijoni i mbyllur kanë në dispozicion vetëm një shëtitore betoni të zbrazët me një kosh basketbolli.

## NDIHMA JURIDIKE

Gjatë realizimit të vizitës u zhvillua një bisedë me nëntë persona të dënuar, pyetjet e të cilëve kishin të bënin me aksesin në kujdesin shëndetësor, lirimin me kusht, shfrytëzimin e privilegjeve dhe transferimin në një institucion tjetër ndëshkimor-korrektues.

### REKOMANDIME:

1. INK Manastir të bëjë përpjekje që personat e dënuar me tretmane të ndryshme të mos grupohen në të njëjtat dhoma;
2. INK Manastir të mundësojë funksionalizimin e kutive për ankesa dhe kërkesa për ekzaminim shëndetësor nga ana e personave të dënuar;
3. Sigurimi i ujit të nxehtë për larje në intervale më të mëdha gjatë ditës;
4. Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masat e mëposhtme:
  - Të sigurojë teste depistimi për droga dhe substanca psikoaktive;
  - Dokumentimi i terapisë dhe gjendjes së klientit gjatë ndryshimit të dozave;
  - Ndryshimi i terapisë duhet të bëhet pas monitorimit dhe vlerësimit të gjendjes së pacientit, pavarësisht nëse terapia është e zvogëluar apo e rritur dhe kur ka nevojë të kryhet psikoedukimi dhe motivimi i pacientit për dozën adekuate;
  - Trajtime për punonjësit e shëndetësisë nëpër burgje;
  - Përgatitja e protokolleve për trajtimin me agonistë opioidë dhe barna të tjera;
  - Përgatitja e protokolleve për trajtimin me benzodiazepina për të parandaluar varësinë ndaj tyre dhe për trajtimin e personave që tashmë kanë krijuar varësi ndaj tyre;
  - Ekzaminim i rregullt për vetëvrasje, hepatit C dhe B, HIV dhe TB dhe trajtim për të gjitha gjendjet pas diagnostikimit dhe indikacionit të përcaktuar;

- Ndërtimi i besimit ndërmjet profesionistëve shëndetësorë dhe personave në burg dhe komunikimi i qartë me personat në burg nga personeli mjekësor për etikën mjekësore dhe konfidencialitetin për sa kohë që nuk rrezikon jetën e personit apo personave të tjerë në burg;
- Sigurimi i sasive të mjaftueshme të buprenorfinës për të gjithë personat e privuar nga liria që kanë nevojë për ilaçin.

# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES OHËR

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Ohrit ka kapacitet për gjithsej 36 fëmijë, ndërsa në momentin e realizimit të vizitës u gjetën 4 fëmijë që vuanin dënimin me burg. Pavijoni i paraburgimit ka një kapacitet prej 12 personash dhe në momentin e vizitës në paraburgim ndodheshin 8 persona.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 33 persona, nga të cilët 24 janë të policisë së burgjeve, 2 edukatorë (psikologë), një person i punësuar në burimet njerëzore, një person i punësuar për pritjen dhe lirimimin e personave, kuzhinier, sekretar teknik, kontabilist dhe një person përgjegjës për prokurimet publike.

## KUSHTET MATERIALE

Kushtet e INK Burgu Ohër vazhdojnë të mbeten nën të gjitha standardet e mundshme. Objekti, i cili është i vjetër, është i pozicionuar në zonën qendrore të qytetit, kurse në afërsi ka objekte banimi, dritaret dhe tarracat e të cilave shikojnë drejtpërdrejt në oborrin e institucionit, prandaj banorët e zonës shpesh thërrasin fëmijët e dënuar.

Përveç dhomave si ambiente akomodimi dhe tualetit të përbashkët, të cilat janë në gjendje jo shumë të keqe, por jo të kënaqshme, fëmijët kanë në dispozicion vetëm një kënd lojërash prej betoni, një dhomë ngrënie dhe një kuzhinë.

Dhomat janë të pajisura me një krevat dhe një dollap, dhe në dhoma ka dritë të mjaftueshme të ditës.

## ARSIMI

Procesi arsimor në INK Ohër është ndërprerë që nga shtatori i vitit 2021. Fëmijët paraprakisht ndiqnin mësimet në gjuhën maqedonase, gjuhën angleze dhe matematikën, por shkollimi në këtë institucion ka përfunduar me përfundimin e projektit që Ministria e Arsimit kishte në bashkëpunim me

UNDP-në. Me këtë, fëmijët në këtë institucion kanë mbetur pa arsim edhe pse nuk e kanë kryer as arsimin fillor dhe janë analfabetë.

## **KUJDESI SHËNDETËSOR**

Kujdesi shëndetësor ofrohet përmes mjekut i cili vjen në institucion një herë në javë, dhe nëse është e nevojshme edhe përmes Shtëpisë së Shëndetit. Ekzaminimet e tjera specialiste të fëmijëve kryhen me udhëzim mjeku. Nëse ndonjëri nga fëmijët ka nevojë të flasë me një psikiatër, ai referohet jashtë institucionit, por ai nuk është një psikiatër për fëmijë. Nga 4 fëmijët, asnjë nuk është i varur nga opiatet. Terapinë mjekësore institucioni e siguron nga fondet vetanake.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Vetëm një fëmijë ishte i angazhuar me punë në kuzhinë. Përveç këndit të lojërave prej betoni, fëmijët nuk kanë në dispozicion kushte për argëtim, sport dhe aktivitete profesionale. Psikologët në institucion, të cilët janë edhe edukatorë të fëmijëve, organizojnë aktivitete dhe punëtori individuale dhe grupe si vizatim, shkrim, dëgjim muzikë, por kjo vështirë se mjafton për nevojat e tyre reale.

Gjyqtarët për fëmijë dhe punonjësit socialë nuk kanë bërë asnjë vizitë, ndonëse janë të obliguar ta bëjnë këtë sipas Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve dhe janë të obliguar të bëjnë vizitë së paku një herë në vit. Ky mosinteresim nga ana e gjyqtarëve dhe punonjësve socialë për trajtimin dhe sjelljen e fëmijëve të dënuar me burg, vetëm sa kontribuon në stigmatizimin shtesë të kësaj kategorie të marginalizuar fëmijësh, të cilët e vuajnë dënimin në kushte të mjerueshme, pothuajse pa asnjë mundësi për risocializimin e tyre. Fëmijët nuk kanë kontakte të shpeshta as me familjet e tyre, të cilët shpesh herë nuk janë të interesuar për ta, nuk u përgjigjen telefonatave, madje as nuk i vizitojnë. Për shkak të kontaktit të rrallë që disa prej fëmijëve kanë me familjet e tyre, ata nuk mund të shfrytëzojnë as të drejtën e privilegjit për t'u larguar nga institucioni në fundjavë, pasi nuk kanë ku të shkojnë. Në një situatë të tillë, punonjësit socialë janë ata që duhet të kryejnë detyrën dhe të ndërmarrin veprime që këta fëmijë pas daljes nga institucioni të kenë strehim, mundësi punësimi dhe me qëllim risocializimin e tyre në shoqëri. Me mosveprimin dhe

moskujdesin e tyre kontribuojnë që këta fëmijë, kryesisht nga familje jofunksionale me të ardhura të ulëta, të jenë autorë të përsëritur të veprave të tjera penale dhe të përfundojnë në një nga institucionet ndëshkimore-korrektuese.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve duhet të marrin masa urgjente dhe të menjëhershme për zhvendosjen e fëmijëve në një objekt tjetër që plotëson standardet e nevojshme;
- 2.** Ministria e Arsimit, në bashkëpunim me institucionet e tjera, të marrë urgjentisht dhe menjëherë masa për vazhdimin e procesit arsimor për fëmijët që ndodhen në burgun e të miturve;
- 3.** Ministria e Shëndetësisë të ofrojë terapi mjekësore për nevojat e fëmijëve;
- 4.** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale duhet urgjentisht të marrë masa që qendrat kompetente për punë sociale të përfshihen aktivisht në mbështetjen e fëmijëve, si gjatë vuajtjes së dënimit me burg ashtu edhe pas përfundimit të vuajtjes së dënimit dhe daljes së tyre nga institucioni, dhe
- 5.** Gjyqtarët për fëmijë duhet të fillojnë të bëjnë vizita në INK Ohër për të kuptuar gjendjen e fëmijëve, se si ndikon dënimi me burg për të mitur, si dhe të bëjnë përpjekje që këta fëmijë më në fund të kenë kushte adekuate për risocializimin e tyre.

# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES BURGU SHKUP

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Shkupit është institucion që numëron gjithsej 146 persona të dënuar, 27 persona në pavijon të mbyllur, 4 persona në pavijonin e pritjes dhe të tjerët në pavijonin e hapur dhe gjysmë të hapur. Ekipi nuk mori informacion për numrin e personave në paraburgim, sepse udhëheqësi i sektorit të risocializimit nuk ishte i njoftuar me këtë informacion. Gjithashtu, gjatë kohës së vizitës ekipi nuk ka mundur të zhvillojë një bisedë me drejtorin, megjithëse vizita ishte planifikuar në kohë.

## KUSHTET MATERIALE

Institucioni ka një pavijon të hapur, gjysmë të hapur, të mbyllur, pavijon të pritjes dhe pavijon për paraburgim.

Pjesa në pavijonin e hapur dhe gjysmë të hapur ka kënd lojërash me pajisje praktike për ushtrime, portë futbollit dhe kosh basketbolli. Dhomat, tualetet dhe korridoret kanë nivel shumë të ulët të higjienës, nga ku përhapet një erë e pakëndshme dhe erë lagështie.

Dhomat në pavijonin e mbyllur në institucion janë në gjendje pak më të mirë për sa i përket kushteve dhe higjienës, ndryshe nga dhomat në pavijonin e hapur dhe gjysmë të hapur, por edhe atje higjiena është në nivel shumë të ulët. Për sa i përket higjienës, përgjegjësi i burgut që është intervistuar, ua kalon përgjegjësinë personave të dënuar me arsyetimin se ata vetë e mirëmbajnë higjienën, gjë që sigurisht nuk është arsyetim për një situatë të tillë në institucion.

Në pjesët e pambuluara të trupit - gjymtyrët e personave të dënuar vërehen ndryshime të lëkurës nga pickimi i insekteve edhe pse përgjegjësit pretendojnë se kryejnë rregullisht dezinfektim, por edhe vetë janë të vetëdijshëm se në burg ka insekte.



Personat e dënuar ankohen për cilësinë e ushqimit në institucion dhe informojnë se kryesisht hanë nga pako ushqimore që i marrin nga jashtë institucionit.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Në pavijonin e mbyllur ndodhet edhe ambulanca në kuadër të institucionit.

Është zhvilluar një bisedë me 6 persona të dënuar nga psikiatri i cili së bashku me ekipin kanë zhvilluar një bisedë edhe me punonjësit e stafit shëndetësor.

Nga bisedat rezultoi se në sektorin e shëndetësisë janë të punësuar tre infermiere, një mjek me kohë të plotë (8 orë) dhe një mjek me kohë të pjesshme (4 orë), dhe një herë në javë (të premtëve) në institucion vjen psikiatër me kontratë për 4 orë që është e barabartë me 0.1 psikiatër, por ai vjen edhe në thirrje kur ka nevojë edhe pse është e paqartë se kush e vlerëson nevojën. Gjatë orëve të pasdites dhe në mbrëmje, nëse ka nevojë për mjek, shërbimet e burgut bëjnë thirrje për ndihmë mjekësore urgjente, por sipas deklaratave të tyre, shërbimi i ndihmës së shpejtë mjekësore jo gjithmonë u përgjigjet thirrjeve të tyre. Shumica e njerëzve në burg raportojnë se edhe mjeku nuk është lehtësisht i aksesueshëm, por psikiatri është ende më pak i aksesueshëm. Në burg janë dy persona që gtrajtohen me buprenorfinë dhe 24 persona në trajtim me metadon. Metadoni përshkruhet në burg, por ka barriera për trajtimin me buprenorfinë, gjegjësisht atë terapi e marrin vetëm ata pacientë që e marrin nga Klinika për Toksikologji dhe Mjekësi Urgjente, e cila natyrisht ka kosto financiare që shpenzohen në mënyrë të paarsyeshme për transportimin e personave në dhe nga klinika ose tërheqjen e rregullt të terapisë nga klinika. Ky organizim i trajtimit me buprenorfinë, përveç faktit që e ndërlikon aksesin dhe disponueshmërinë e barit në fjalë dhe numrin e personave që trajtohen me buprenorfinë (vetëm 2), nuk ka asnjë shpjegim tjetër racional për këtë organizim të trajtimit me të cilin në vend që të shpenzohen para për akses më të madh në ilaç, paratë shpenzohen për transport për shkuarje dhe ardhje nga Klinika e Toksikologjisë.

Gjatë vizitës ekipi ka konstatuar se ndaj një personi të dënuar në vazhdimësi për disa ditë janë përdorur rripa lëkure (pranga) në institucionin ndëshkimor-korrektues Burgu Shkup, gjë që mund të cilësohet si trajtim çnjerëzor dhe poshtëruës. Arsyeja e përdorimit të këtyre rripave (pranga) lëkure është sjellja

agresive e personit të dënuar, e cila sigurisht nuk është zgjidhje afatgjatë për këtë situatë. Gjegjësisht, shteti e ka për obligim të bëjë depistime dhe vlerësime për çrregullimet mendore dhe hiperaktivitetit tek personat e dënuar dhe të sigurojë trajtim adekuat të asaj gjendjeje, në vend të fiksimit të përditshëm me rripa lëkure.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Gjatë kohës së vizitës u zhvillua një bisedë me dhjetë persona të dënuar, pyetjet dhe ankesat e të cilëve kishin të bënin kryesisht me lirimin me kusht, kujdesin shëndetësor, shfrytëzimin e privilegjeve, faljen, kalimin në trajtim më liberal, përdorimin e instrumentëve juridikë për vendimet me të cilët shqiptohen masa disiplinore.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve të përmirësojë kushtet materiale në institucion (krevatet, shtretërit, dyshekët, lyerjen e mureve, ndërrimin e dyerve, dritareve, dyshemesë etj.);
- 2.** INK Shkup të bëjë më shpesh dezinfektimin në institucion për të parandaluar shfaqjen e çimjave dhe insekteve tjera që pickojnë personat e dënuar;
- 3.** Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve dhe INK Shkup të bëjnë përpjekje për përmirësimin e cilësisë dhe sasisë së ushqimit në institucion;
- 4.** Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masat e mëposhtme:
  - Të marrë përsipër plotësisht kujdesin shëndetësor për personat e privuar nga liria, duke përfshirë sigurimin e barnave të nevojshme për personat e privuar nga liria;
  - Trajtimi me OAT-buprenorfinë duhet të administrohet në burg siç bëhet me OAT-metadon;

- Të bëhet një kontroll dhe vlerësim veçanërisht për çrregullimet psikiatrike dhe t'i regjistrojë ato në kartelat shëndetësore (varësia, çrregullimet e vëmendjes dhe hiperaktiviteti, vetëvrasja, etj.);
- Pas depistimit dhe vlerësimit të personat e dënuar në burgje për çrregullime të vëmendjes dhe hiperaktivitetit, të sigurohet trajtimi adekuat i asaj gjendjeje, pra të sigurohen barnat.

# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES STRUMICË

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Strumicës ka kapacitet për 92 persona të dënuar, ndërsa në momentin e vizitës numri i përgjithshëm i personave të dënuar ishte 94, të shpërndarë në tretmanin A, B dhe C.

Përveç drejtorit (dhe zëvendësdrejtorit), ky institucion ndëshkimor-korrektues ka 23 të punësuar, 15 prej të cilëve policë të burgjeve, 2 edukatorë në sektorin e risocializimit, një agronom, një inxhinier dhe një kuzhinier.

## KUSHTET MATERIALE

Në krahasim me vizitën e realizuar në vitin 2020, ambientet e institucionit ndëshkimor-korrektues janë përmirësuar dukshëm, gjë që ka rritur edhe kapacitetin për personat e dënuar. Të gjitha dhomat janë rikonstruktuar, në të cilat është ndërruar dyshemeja, dyert në dhoma, shtretërit kanë dyshekë dhe çarshafë të pastër, dhe çdo i dënuar ka një dollap për mbajtjen e sendeve personale. Në dhoma ka dritë natyrale dhe artificiale të mjaftueshme, kurse higjiena në dhoma është në nivel të kënaqshëm. Në institucion ka gjithsej 5 tualete, të cilat gjithashtu janë rikonstruktuar me çezma dhe dushe funksionale. Në njërin nga dhomat u regjistrua rritje e lagështisë, përkatësisht 59%, e cila mund të jetë për shkak të periudhës së reshjeve gjatë kohës së vizitës.

Edhe dhomat e izolimit janë me kushte të përmirësuara, me sistem funksional të thirrjeve dhe me dritë të mjaftueshme të ditës dhe dritë artificiale.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në burg ofrohet në atë mënyrë që një mjek i mjekësisë së përgjithshme dhe një infermiere vijnë dy herë në javë. Drejtori i Burgut të Strumicës na informoi se nuk kanë problem me furnizimin me barna, që paraqet një ndryshim nga vizita e fundit e kryer në vitin 2020 kur institucioni

përballej me atë problem. Nëse personat e dënuar kanë nevojë të vizitojnë dentistin, kjo bëhet jashtë institucionit.

## **ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA**

Personat e dënuar janë të angazhuar me punë në gjykatë, në qendrën shëndetësore, në polici, në prokurori dhe rreth 7-8 persona të dënuar janë të angazhuar jashtë institucionit në një kompani. Përveç kësaj, disa nga personat e dënuar janë të angazhuar në sektorin e bujqësisë në kuadër të institucionit ku kultivojnë perime të ndryshme.

Oborri i objektit është i gjerë, me kënd lojërash, palestër dhe disa gazebo ku personat e dënuar mund të kalojnë kohën e tyre të lirë. Gjatë kohës së vizitës u vërejt që ndërtohej një kishe në oborr, në ndërtimin e së cilës marrin pjesë edhe personat e dënuar.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Katër persona të dënuar kanë kërkuar këshillim ligjor lidhur me të drejtën e liritimit me kusht.

## **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Nga janari deri në gusht të vitit 2022 janë inicuar gjithsej 20 procedura disiplinore dhe janë shqiptuar 20 masa disiplinore. Shumica e procedurave disiplinore janë zhvilluar për posedimin e një celulari, gjithsej shtatë. Ndaj vendimeve të marra nuk ka pasur ankesa.

## **REKOMANDIME:**

1. Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve të bëjnë përpjekje për të kapërcyer problemin e mbipopullimit në këtë institucion.

# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES TETOVË

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Tetovës ka një kapacitet të përgjithshëm për 48 persona, ndërsa në momentin e vizitës dënimin e vuanin gjithsej 80 persona të dënuar.

Në institucion janë të punësuar gjithsej 34 persona, nga të cilët 29 janë policë të burgjeve, 2 juristë, një sociolog, një psikolog dhe një pedagog në sektorin e risocializimit.

## KUSHTET MATERIALE

Në institucion është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura, për të cilën shteti nuk ka dhënë asnjë kontribut, pra rikonstruksioni i përgjithshëm është bërë me iniciativën e drejtorit të institucionit. Edhe pse përmirësimi i kushteve është një ndryshim pozitiv, e njëjta gjë është bërë përmes kontakteve private dhe donacioneve dhe në asnjë rast nuk pasqyron gjendjen reale në sistemin penitenciar në vendin dhe as nuk mund të themi se do të ishte e qëndrueshme në të ardhmen nëse bëhet ndonjë ndryshim i pozitës drejtuese.

Pavijoni i hapur dhe gjysmë i hapur në objekt është rikonstruktuar, dhomat kanë dysheme të reja, dyer, dyshekë dhe shtroje të reja dhe të pastra. Dhomat janë me kapacitet nga 4 deri në 6 shtretër, por institucioni na informoi se kapaciteti i plotë i shtretërve nuk plotësohet pothuajse asnjëherë, me qëllim që të dënuarit të kenë më shumë komoditet nëpër dhoma. Përpara çdo dhome ka dollapë të veçantë për këpucët e personave të dënuar. Përveç dhomave, janë rikonstruktuar edhe korridoret përballë dhomave. Nga fundi i shtatorit 2022, tualetet në objekt do të rikonstruktohen plotësisht.

Pavijoni i pritjes në institucion ka 1 dhomë gjumi me 4 krevate në 2 kate me tualet dhe një dhomë tjetër që të dënuarit e përdorin si sallon për të ngrënë dhe për të parë TV.

Është rikonstruktuar tërësisht edhe pavijoni i mbyllur në objekt, me 2 dhoma me nga 4 krevate. Në korridorin e pavijonit të mbyllur ka edhe një bibliotekë të vogël për personat e dënuar.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në burg ofrohet në atë mënyrë që çdo ditë në institucion vjen një mjek për të ekzaminuar personat e dënuar. Për shkak se mjeku është në pushim mjekësor, në momentin e vizitës kujdesin shëndetësor e kanë bërë edhe mjekë të tjerë që vizitojnë burgun, por angazhimi i tyre zgjat më pak orë se mjeku i mëparshëm. Gjatë kohës së vizitës, gjithsej 5 persona të dënuar ishin në terapi me metadon.

Ambulanca në institucion, përveç sallës për ekzaminimin e personave të dënuar, shërben edhe si zyrë për punonjësit e administratës.

Psikiatri nga ekipi vëren se përveç terapisë me metadon, nuk jepen anksiolitike për të parandaluar varësitë e tjera dhe abuzimin e mundshëm të drogës në burg. Në të njëjtën kohë, është vërejtur se institucioni shpesh herë parashtron propozim për pezullimin e vuajtjes së dënimit me burg për shkak të mjekimeve të pamjaftueshme në institucion.

## ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA

Gjithsej 11 persona të dënuar janë të angazhuar me punë brenda institucionit dhe 12 persona të dënuar jashtë institucionit.

Oborri në institucion është rikonstruktuar tërësisht dhe pajisur për aktivitete të lira të personave të dënuar. Është ndërtuar berberia, është pajisur biblioteka, palestra, bufeja, është ndërtuar salla për ligjërata të të dënuarve me kompjuter dhe projektor, si dhe gjatë kohës së vizitës ishte vendosur një pishinë në oborrin e institucionit.

Në institucion ka 1 telefon zyrtar dhe 1 tablet që personat e dënuar mund t'i përdorin për kontakte me botën e jashtme. Megjithatë, numri më i madh i procedurave disiplinore ndaj personave të dënuar janë për posedim të telefonit celular, që konsiderohet si kundërvajtje më e rëndë disiplinore. Kështu, në tremujorin e parë të vitit 2022, nga gjithsej 15 procedime disiplinore, 12 janë për posedim të telefonit celular, për të cilin personat e dënuar zakonisht dënohen me izolim prej 5 ditësh.

Në institucion ende nuk ka dhoma të përshtatura për vizitën e personave të dënuar me të afërmit e tyre, kështu që jashtë para institucionit janë bërë strehe në stola që të mund të shfrytëzohen për vizita edhe në kushte të pafavorshme atmosferike.

## **NDIHMA JURIDIKE**

Gjatë vizitës është zhvilluar bisedë me dy persona të dënuar, pyetjet dhe ankesat e të cilëve kanë të bëjnë me pezullimin e vuajtjes së dënimit me burg në bazë të trajtimit mjekësor dhe në lidhje me procedurën e shqiptimit të një dënimi të vetëm me burgim.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** Është e nevojshme të zgjidhet problemi i mbipopullimit në INK Tetovë
- 2.** Nga Ministria e Shëndetësisë kërkohet që të sigurojë rregullisht terapinë e nevojshme mjekësore për personat e dënuar dhe të sigurojë mjekun që do t'i ekzaminojë personat e dënuar, gjegjësisht të mos bëhet përmes Shërbimit Emergjent;
- 3.** Nga Ministria e Shëndetësisë kërkohet të ofrojë shërbime të rregullta psikiatrike për personat e dënuar;
- 4.** Është e nevojshme të gjendet mënyra që personat e dënuar të kenë takime me familjarët e tyre. Një zgjidhje e përkohshme jashtë nuk është një zgjidhje afatgjatë për këtë problem, duke pasur parasysh se hapësira nuk mund të përdoret në të gjitha kushtet atmosferike dhe
- 5.** Duhet gjetur një zgjidhje që punonjësit e administratës të mos ndajnë hapësirën me mjekët në ambulancë, pra të kenë dhomën e tyre të veçantë që do të shërbejë si zyrë.



# INSTITUCIONI NDËSHKIMOR - KORREKTUES GJEVGJELI

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Burgu i Gjevgjelisë ka kapacitet për 69 persona të dënuar dhe në momentin e vizitës, dënimin me burg e vuanin 55 persona, ndërsa pavijoni i paraburgimit ka kapacitet për 12 persona dhe në momentin e vizitës masën e paraburgimit e vuanin 8 persona.

Numri i përgjithshëm i punonjësve në institucion është 28 persona, nga të cilët 20 janë policë të burgjeve, 2 punonjës në sektorin e risocializimit, një jurist, një arkivist, një kuzhinier dhe pjesa tjetër në administratë.

## KUSHTET MATERIALE

Ambientet në institucion janë ende në gjendje të kënaqshme me dyshekë dhe çarshafë të pasër, dritë të mjaftueshme të ditës dhe dritë artificiale dhe në dhoma ka mesatarisht 8 persona të dënuar. Pavijoni i pritjes në institucion ka 2 dhoma me 4 shtretër secila, të cilat gjithashtu plotësojnë standardet e nevojshme dhe kanë nivel të kënaqshëm të higjienës.

Personat e dënuar kanë në dispozicion 3 tualete me 3 dushe funksionale, njërin prej të cilëve e përdorin personat e dënuar të angazhuar me punë në kuzhinë.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Kujdesi shëndetësor në burg ofrohet në marrëveshje me ISHP Shtëpia e Shëndetit Gjevgjeli, me një mjek që vjen dy herë në javë për t'i ekzaminuar personat e dënuar dhe nëse është e nevojshme, të dënuarit dërgohen për ekzaminim në Shtëpinë e Shëndetit Gjevgjeli ose duke telefonuar Shërbimin e Urgjencës Mjekësore. Një psikiatër vjen një herë në javë për të ekzaminuar personat e dënuar. Në momentin e vizitës, 7 persona të dënuar ishin me terapi metadoni, ndërsa 4 të dënuar me buprenofinë. Terapia shpërndahehet nga pjesëtarët e policisë së burgjeve.

## ANGAZHIMI NË PUNË DHE AKTIVITETET E LIRA

Dy persona të dënuar janë të punësuar në fermën e derrave, 3 në kuzhinë, 4 për prodhimin e ushqimit të kafshëve dhe 3 në portë. Sfidat më të mëdha për institucionin është risocializimi i personave të dënuar. Gjegjësisht, edhe pse institucioni ka persona të punësuar për risocializim, institucioni megjithatë ofron kushte për personat e dënuar që të fitojnë disa aftësi që do t'u jenë të dobishme pas daljes nga institucioni.

Oborri i institucionit është i pajisur me një fushë futbollit me bar, një kosh basketbolli dhe një palestër.

## NDIHMA JURIDIKE

Pesë persona të dënuar kanë marrë këshillim juridik lidhur me të drejtën e lirit me kusht dhe qasjen në kujdesin shëndetësor.

## REKOMANDIME:

1. Nga Ministria e Shëndetësisë kërkohet të punësojë një mjek i cili do të administrojë terapinë mjekësore personave të dënuar dhe do të bëjë ekzaminimin e tyre shëndetësor dhe
2. Drejtoria për ekzekutimin e sanksioneve të sigurojë kushte për të mundësuar zbatimin e programeve të risocializimit të personave të dënuar.

# SHTËPIA EDUKATIVE - KORREKTUESE TETOVË

## TË DHËNA TË PËRGJITHSHME

Shtëpia edukative-korrektuese Tetovë ndodhet në fshatin Vollkovi dhe është hapur në nëntor të vitit 2020. Kapaciteti i përgjithshëm i objektit është për 110 persona, ndërsa në momentin e vizitës aty ishin akomoduar 17 fëmijë, 1 person ishte në arrati, ndërsa 1 person ishte i shtruar në ISHP Spitali Psikiatrik në Demir Hisar. Nga të gjithë fëmijët, 10 janë në moshë madhore dhe 9 të mitur. Kapaciteti i institucionit nuk korrespondon aspak me numrin e fëmijëve që janë dërguar vitet e fundit për të vuajtur masën edukative-korrektuese, gjë që shtrton pyetjen se përse është ndërtuar ky objekt, për të cilin janë shpenzuar në mënyrë të panevojshme kaq shumë mjete financiare.

Numri i përgjithshëm i të punësuarve në institucion, përveç drejtorit dhe zëvendës drejtorit është 51, nga të cilët policia e burgjeve 26, sektori i risocializimit 13 dhe 5 instruktorë (ekonomi, hidraulik, kaldajë dhe hoteleri).

## KUSHTET MATERIALE

Objekti është i ri dhe tani për tani mjaft i ruajtur, kurse kushtet përmirësohen vazhdimisht. Në funksion janë vënë 14 dhoma dhe 2 dhoma në pavijonin e pritjes. Të gjitha dhomat janë të pajisura me krevate në 2 kate, tavolinë, dollapë, televizor dhe tualet. Dhomat kanë dritë të mjaftueshme natyrale dhe artificiale, nuk ka lagështi dhe ka ajrim të mirë.

Institucioni ka 4 dhoma të veçanta për punë në grup me fëmijët, klasa, një hapësirë për komponimin e muzikës dhe klasa për ndjekjen e mësimin.

Oborri i institucionit është i pajisur me një kënd lojërash me kosh basketbolli dhe një portë futbollit, një kishë të vogël, disa gazebo, një zgarë dhe një shatërvan që janë bërë nga fëmijët me ndihmën e punonjësve të institucionit, si dhe një kopsht në cilat janë mbjellë patate, domate, kumbulla etj.

Institucioni gjithashtu ka përshtatur ambiente me një kapacitet total prej 6 dhomash për rritjen e ndikimit edukativ të fëmijëve që janë autorë të veprave disiplinore dhe që kanë sjellje të papërshtatshme.

Fëmijët kanë në dispozicion edhe një kuzhinë për çaj dhe kafe, një dhomë lutjeje dhe një lavaxteri ku është i angazhuar një fëmijë për trajnim për të përvetësuar shprehi të caktuara.

## ARSIMI

Arsimi formal që zbatohet në shtëpinë edukative-korrektuese është pezulluar nga shtatori 2021 deri në korrik 2022, me përfundimin e projektit ndërmjet UNDP-së dhe Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës. Me këtë, fëmijëve që vuanin masën edukative-korrektuese iu është hequr e drejta e arsimit, një e drejtë me rëndësi thelbësore për procesin e risocializimit të tyre. Më pas, procesi edukativo-arsimor ka vazhduar të zbatohet sërish në institucion, por këtë herë edhe me një projekt të mbështetur nga UNDP-ja. Fëmijët të cilët tashmë kanë përfunduar një nivel më të lartë të arsimit ndjekin dhjetë lëndë, ndërsa fëmijët e tjerë ndjekin 3 lëndë, përkatesisht gjuhë maqedonase, gjuhë angleze dhe matematikë. Mësimi zhvillohet në kuadër të institucionit përmes mësimdhënësve të angazhuar nga shkolla për të rritur “Makarenko” në komunën e Çairit, Shkup. Fatkeqësisht, procesi edukativo-arsimor është joformal, respektivisht fëmijët që ndjekin mësimet në fund të vitit marrin vërtetime, e jo dëftesa formale, e cila nuk duhet të ndryshojë nga ajo që marrin fëmijët jashtë nëpër shkolla. Në këtë mënyrë, edukimi/arsimimi që përfiton një fëmijë në këtë institucion nuk është i njëjtë me arsimimin/edukimin që fëmijët marrin jashtë dhe me këtë ata kanë vështirësi në procesin e punësimit, dhënien e provimit për patentë shofer etj.

## QENDRAT PËR PUNË SOCIALE DHE GJYKATËSIT PËR FËMIJË

Krahas mangësive në arsimin jo të rregullt që ndikojnë veçanërisht në procesin e përgjithshëm të risocializimit të fëmijëve, gjykatësit për fëmijë, me përjashtim të një gjykatësi, madje as punonjësit social në përgjithësi nuk kryejnë vizita të rregullta në institucion për të biseduar me fëmijët dhe punonjësit, për të monitoruar se si po zbatohet masa edukative-korrektuese, gjegjësisht çfarë efekti ka te fëmijët.

Qendrat për punë sociale nuk ofrojnë akomodim të përkohshëm për fëmijët që nuk kanë ku të shkojnë gjatë pushimeve shkollore, pushimeve dhe fundjavëve, madje as nuk bëjnë përpjekje për të ndihmuar disa prej fëmijëve që të përmirësojnë marrëdhëniet e tyre familjare me prindërit.

Gjykatësit për fëmijë, vendimin e tyre nëse fëmija duhet të qëndrojë në shtëpinë edukative-korrektuese apo të largohet nga institucioni e bazojnë vetëm në dokumentacionin që shtëpia edukative-korrektuese do të dorëzojë në gjykatën kompetente. Ata nuk i vizitojnë fëmijët në institucion, nuk bëjnë biseda individuale me ta, gjë që sigurisht është e nevojshme për një vendim të drejtë gjyqësor.

## KUJDESI SHËNDETËSOR

Institucioni ka një ambulancë të pajisur plotësisht për ekzaminimin e fëmijëve, e cila kryhet nga mjekë të Shërbimit Mjekësor të Urgjencës, që vijnë një herë në javë ose më rrallë dhe një infermiere e punësuar me marrëdhënie të rregullt pune në institucion. Më parë, kujdesin shëndetësor e ka ofruar një mjek i cili para dhe gjatë kohës së vizitës kishte qenë në pushim mjekësor. Ordinanca stomatologjike në institucion është gjithashtu e pajisur plotësisht, ndërsa shërbimet stomatologjike i kryen një stomatolog i cili vjen një herë në javë.

Mjekët e shërbimit të urgjencës, si më parë mjeku i praktikës së përgjithshme, nuk kanë akses në shërbimin Termini im, ndaj nuk mund të lëshojnë as udhëzim elektronik dhe as të monitorojnë dokumentacionin elektronik të fëmijëve pacientë. Ka ndodhur që fëmijët janë kthyer nga një institucion shëndetësor me një udhëzim jo elektronik por të shkruar në letër, kështu që drejtori përmes ndërhyrjeve personale ka arritur të sigurojë një mjek familjar për çdo fëmijë i cili vetëm lëshon udhëzimet elektronike pa e ekzaminuar fëmijën, sipas konstatimeve të mjekut të urgjencës ose mjekut të përgjithshëm që viziton shtëpinë dhe ekzaminon fëmijët. Të gjithë fëmijët në shtëpinë edukative-korrektuese kanë sigurim shëndetësor. Gjatë vizitës është biseduar me ekipin e ndihmës së shpejtë, të cilët kanë bërë të ditur se nuk kanë shumë kohë për të qëndruar në institucion sepse janë një numër i vogël ekipesh për qytetin dhe se nuk mund t'i përgjigjen në mënyrë optimale nevojave të institucionit. Gjithashtu ata bëjnë të ditur se trajnimi i tyre është për situata dhe ndërhyrje emergjente. Në momentin e vizitës infermierja ndodhet në pushim mjekësor, ndaj terapia ofrohet nga të punësuarit e institucionit.

Institucioni na ka njoftuar se ka teste depistimi për testimin e drogës në urinë, por nuk ka antidot për opiatet dhe benzodiazepinat. Gjithashtu nuk ka teste depistimi për hepatitin B, C dhe HIV, madje as prezervativë pasi Avokati i Popullit ka pasur vërejtje mbi aksesin e tyre në institucionet për të mitur siç është shtëpia edukative-korrektuese. Pas vizitës, nga një punonjës i institucionit përmes telefonit morëm informacion se të gjithë fëmijët janë testuar dhe këshilluar për hepatitin C dhe B nga një organizatë civile në ditët në vijim të vizitës sonë dhe asnjë fëmijë nuk ka rezultuar pozitiv me këto viruse. Ata ranë dakord me të njëjtën organizatë se kur do të jenë në gjendje të testojnë dhe këshillojnë fëmijët për HIV-in. Mirëpo, kjo nuk është bërë në bashkëpunim me sektorin e shëndetësisë të OJQ-ve, por me punonjësit e institucionit, të cilët, duke njohur kapacitetin e pamjaftueshëm të sektorit shëndetësor, ndërmarrin aktivitete për përmirësimin e situatës, edhe pse nuk duhet ta bëjnë këtë. Dokumentacioni mjekësor si dhe rezultatet e këtij testi të fundit janë në dispozicion të punonjësve që nuk janë nga sektori i shëndetësisë

sepse ata vetë japin terapinë e përshkruar nga mjeku në rastet kur mungon infermierja. Institucioni ka marrë një donacion, një aparat reanimimi dhe një EKG, por të njëjtat nuk i përdorin, madje as stafi nuk ka trajnime për përdorimin e tyre. Dokumentacioni shëndetësor (kartoni) nuk mirëmbahet rregullisht dhe ashtu siç duhet, respektivisht pas kohës që mjeku kishte shkuar në pushim mjekësor nuk është bërë asnjë ndryshim në karton, megjithëse janë bërë disa ndryshime në ditarin e mjekut. Jo pak fëmijë kanë diagnozën e varësisë ndaj opiateve, ndoshta diku dhe gabimisht sepse në ato raste bëhet fjalë për përdorimin e kanabisit, e jo opiateve. Te trajtimi i varësisë ndaj opiateve te disa fëmijë përdoret trodon, me shumë mundësi për shkak se nuk ka qasje në barna të tjera (buprenorfina, metadoni). Te një pacient është përshkruar tramadol për 3 ditë, që është e pakuptueshme nga pikëpamja profesionale/mjekësore. Te këta fëmijë me sindromën e varësisë ndaj opiateve, si dhe te fëmijët me çrregullime të tjera psikiatrike, shpesh përdoren qetësues dhe hipnotikë (preparate për qetësim dhe për gjumë), kryesisht në afat të gjatë, gjë që sjell rrezikun e paraqitjes së varësisë jatrogjene. Përveç varësisë ndaj opiateve, fëmijët diagnostikohen edhe me depresion, ankth, çrregullime të gjumit, çrregullime të sjelljes dhe të tjera, kurse për trajtimin e tyre përdoren antidepresivë dhe ndonjëherë neuroleptikë. Fëmijët shumë shpesh i refuzojnë këto barna dhe kërkojnë qetësues dhe tableta gjumi dhe disa prej fëmijëve tashmë po shfaqin simptoma të varësisë ndaj tyre. Raportet nga psikiatri janë nga një psikiatër për të rritur, sepse në Tetovë nuk ka psikiatër për fëmijë, por edhe po të kishte, psikiatërit e fëmijëve nuk janë fare, ose nuk janë mjaftueshëm të trajnuar për trajtimin e varësive dhe varësisë ndaj opiateve, madje as nuk i administrojnë barnat buprenorfinë dhe metadon. Stafi i shtëpisë shpjegon se çfarë përjetojnë kur kanë një fëmijë me një krizë abstinenciale nga opiatet. Ata rrëfyan për një rast kur një fëmijë me varësi ndaj opiateve nuk është pranuar në Qendrën e varësisë në Tetovë për shkak se aty trajtohen të rriturit, madje as në Tetovë e as askund tjetër në vend nuk ka program për trajtimin e varësive për fëmijë dhe nuk ekziston asnjë protokoll për trajtimin e varësisë te fëmijët. Në anën tjetër, mjekët psikiatër të fëmijëve, të cilët sigurisht nuk mund të gjenden në Tetovë, por edhe atje ku ka, nuk janë fare, ose nuk janë mjaftueshëm të trajnuar për trajtimin e varësisë nga droga. Ata treguan gjithashtu se për fëmijën në krizë abstinenciale kishin frikë se mos vdiste sepse ishte në krizë të rëndë abstinenciale, madje kanë telefonuar ndihmën e shpejtë 2 herë në ditë. Ai vuante shumë, madje nuk pranonte të tymoste një cigare, që ishte një shenjë për stafin se fëmija ishte vërtet në gjendje shumë të vështirë. Kriza e opiateve te femija është trajtuar me shumë mundësi simptomatikusht dhe fëmija ka vuajtur deri në përfundimin e krizës, sepse nuk ishte administruar terapia me opioid për shkak të arsyeve të mësipërme (mungesa e programit, institucionit, protokollit dhe personelit të

trajnuar për trajtimin e fëmijëve me varësi) që në fakt është trajtim çnjerëzor i një fëmije të varur nga opiatet dhe i privuar nga liria. Në institucion si punonjësit, ashtu edhe fëmijët, rrëfyan se rrallë, pothuajse asnjëherë nuk ka dhunë mes fëmijëve, nuk ka drogë dhe nuk manipulohet me barnat që marrin fëmijët.

## **PROCEDURAT DISIPLINORE**

Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar 6 procedime disiplinore ndaj fëmijëve, përkatësisht 3 për arratisje, 2 për keqpërdorim të privilegjeve dhe 1 për sulm fizik. Masat që janë shqiptuar ishin referim në dhomë të veçantë për sulmin fizik që ishte në fakt një masë me kusht, kurse për dy kundërvajtjet e tjera disiplinore ishte shqiptuar masë referimi në dhomë në kohëzgjatje prej 7 ditësh.

Sipas Udhëzimit për përgjegjësi disiplinore për fëmijët që vuajnë një masë edukative – referim në shtëpi edukative-korrektuese – në Republikën e Maqedonisë së Veriut të miratuar në tetor të vitit 2021, fëmijët nuk kanë të drejtë të kundërshtojnë/ankimojnë vendimin për shqiptimin e masës disiplinore.

Me këtë, fëmijëve iu hiqet e drejta për instrumente efektive juridike, që është në kundërshtim edhe me nenin 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, e cila garanton që personat të cilëve u janë kërcënuar të drejtat, siç është ndalimi i torturës i definuar në përputhje me Konventën, duhet të ketë në dispozicion një instrument efektiv juridik para institucioneve kompetente, pavarësisht nëse kjo shkelje është kryer nga ana e personave gjatë kryerjes së veprimeve të tyre zyrtare.

## **REKOMANDIME:**

- 1.** Ministria e Arsimit duhet urgjentisht dhe menjëherë të organizojë dhe financojë plotësisht procesin arsimor në INK-të;
- 2.** Për rekomandimin e kujdesit shëndetësor;
- 3.** Ndryshimi i nenit 16 paragrafi 3 i Udhëzimit për përgjegjësi disiplinore për fëmijët që vuajnë masë edukative, i cili nuk i lejon fëmijës ankesë kundër vendimit për masën e shqiptuar disiplinore;
- 4.** Ministria e Punës dhe Politikës Sociale të marrë masa për përmbushjen e detyrimeve të qendrave kompetente për punë sociale për mbështetjen e fëmijëve të cilët janë nën masën edukative korrektuese dhe mbështetjen e tyre postpenale;

5. Nga gjykatësit për fëmijë kërkohet që të bëjnë vizita të rregullta në shtëpinë edukative-korrektuese për të shqyrtuar efektin e masës institucionale mbi fëmijët dhe risocializimin e tyre;
6. Ministria e Shëndetësisë duhet të marrë masat e mëposhtme:
  - Është e nevojshme t'u mundësohet mjekëve dhe infermierëve të SHEK-ëve të kenë qasje dhe të punojnë në Sistemin Kombëtar të Regjistrimeve Elektronike të Shëndetit - Termini im;
  - Ekziston nevoja për të ofruar trajnime për mjekët e SHEK-ëve për parandalimin e drogës dhe parandalimin e varësisë, duke përfshirë varësinë jatrogjenike nga përdorimi i tepërt i qetësuesve dhe hipnotikëve, si dhe për vlerësimin dhe trajtimin nga drogat, duke përfshirë opiatet dhe gjendjet e tjera shoqëruese mendore;
  - Është e nevojshme të sigurohet një program trajtimi për personat e mitur me çrregullime të përdorimit të drogës, duke përfshirë barnat opiate dhe protokollet e trajtimit për të siguruar trajtim human dhe mungesë të vuajtjes nga simptomat apstinenciale;
  - Është i nevojshëm psikoedukimi, monitorimi dhe vlerësimi i rregullt i gjendjes gjatë detoksifikimit nga preparatet për qetësim/gjum. Në rastin e një varësie të zhvilluar ndaj këtyre barnave, trajtimi duhet të kryhet nga një psikiatër/psikiatër fëmijësh në kushte spitalore ose ambulatore në varësi të ashpërsisë së pamjes klinike me ndjekjen e nevojshme të trajtimit dhe kujdesit afatgjatë psikosocial për parandalimin e pasojave, të cilat mund të ndodhin në një përqindje të madhe për shkak të natyrës së sëmundjes;
  - Ka nevojë për mirëmbajtjen e rregullt, të saktë, precize dhe konfidenciale të të dhënave mjekësore;
  - Psikoedukimi i fëmijëve për rrezikun e përdorimit të tepërt të qetësuesve dhe barnave të gjumit;
  - Psikoedukimi i fëmijëve për rrezikun e mbidozimit pas abstinencës së suksesshme nga droga (opiatet);
  - Sigurimi i antidoteve për opiatet dhe benzodiazepinat si dhe teste depistimi për hepatitin B, C dhe HIV.




## REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME:

1. Zbatimi adekuat i akteve ligjore dhe nënligjore nga të gjitha institucionet kompetente në fushën e sistemit penitenciar;
2. Sigurimi i kushteve materiale të përshtatshme dhe humane në të gjitha institucionet penitenciare nga ana e Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë për ekzekutimin e sanksioneve;
3. Sigurimi i qasjes adekuate në kujdesin parësor dhe dytësor shëndetësor nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë;
4. Organizimi dhe financimi i plotë i procesit arsimor nga Ministria e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për ekzekutimin e sanksioneve, Ministrinë e Drejtësisë dhe Shtëpinë edukuese-korrektuese;
5. Sigurimi i kushteve për zbatimin e programeve të risocializimit në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese;
6. Forcimi i kapaciteteve dhe profesionalizmit të stafit të punësuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese;
7. Përcaktimi dhe miratimi i një shume të mjaftueshme burimesh financiare nga Ministria e Financave për nevojën e funksionimit të pandërprerë, adekuate dhe më të mirë të institucioneve ndëshkimore-korrektuese, siç janë punësimi i personelit të ri, avancimi në punë i punonjësve ekzistues, përmirësimi i kushteve materiale, kryerja e trajnimeve, etj.;
8. Zgjidhja afatgjatë e problemit të mbipopullimit në institucionet ndëshkimore-korrektuese;
9. Përmirësimi i përfaqësimit gjinor brenda personelit të punësuar në institucionet ndëshkimore-korrektuese.

## Aneksi (Shtojca) I

| Vizita në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe në institucionin edukativo-korrektues |  |
|---|--|
| 5.5.2022  | SHNK Kumanovë – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, avokati Eleonora Pelovska, psikiatri Liljana Ignjatova dhe psikiatri Marija Kostadinovska |
| 25.5.2022   | INK Shkup – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova, avokati Tatjana Doneska dhe psikiatri Liljana Ignjatova                      |
| 31.5.2022   | SHNK Idrizovë – pavijoni i hapur Veles – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi dhe avokati Tamara Slavevska Apostolovski                         |
| 1.6.2022  | SHNK Idrizovë – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova dhe psikiatri Liljana Ignjatova   |
| 3.6.2022  | SHNK Idrizovë – psikiatri Marija Kostadinovska   |
| 7.6.2022  | SHNK Kumanovë – pavijoni i hapur Kriva Pallankë Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi dhe avokati Pavlina Zefiq                                  |
| 13.6.2022   | INK Strumicë – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi dhe avokati Netka Kovaçevska  |
| 20.6.2022   | INK Gjevgjeli – Ina Xhugumanova dhe avokati Aleksandra Mihajlova   |

|           |   |
|-----------|---|
| 30.6.2022 | SHNK Shtip – Arben Gudaçi, avokati Srgjan Amet dhe psikiatri Liljana Ignjatova                |
| 6.7.2022  | INK Tetovë – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi dhe avokati Darko Koteski                          |
| 14.7.2022 | INK Prilep – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova dhe avokati Aleksandar Goxho      |
| 22.7.2022 | INK Prilep – psikiatri Liljana Ignjatova  |
| 15.7.2022 | INK Manastir – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi, Irena Zdravkova dhe avokati Marija Kelepurovska |
| 29.7.2022 | INK Manastir – psikiatri Liljana Ignjatova  |
| 20.7.2022 | INK Ohër – Ina Xhugumanova dhe Arben Gudaçi   |
| 21.7.2022 | INK Strugë – Ina Xhugumanova, Arben Gudaçi dhe avokati Marga Sotiroska                        |
| 5.8.2022  | SHEK Tetovë – Ina Xhugumanova dhe psikiatri Liljana Ignjatova                                 |



RAPORT PËR  
**GJENDJEN DHE KUSHTET  
NË INSTITUCIONET  
NDËSHKIMORE-KORREKTUESE DHE  
INSTITUCIONIN EDUKATIVO-KORREKTUES**  
NË VITIN 2022